



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 109

**Tiranë – E martë, 25 korrik 2023**

## PËRMBAJTJA

|                                                  | Faqe                                                                                                                                                                                           |
|--------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr. 51/2023,<br>datë 6.7.2023               | Për disa ndryshime në ligjin nr. 91/2013, “Për vlerësimin strategjik mjedisor”..... 11215                                                                                                      |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 144, datë 20.7.2023  | Për shpallje ligji..... 11215                                                                                                                                                                  |
| Ligj nr. 53/2023,<br>datë 6.7.2023               | Për ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Shtypjen e Akteve të Terrorizmit Bërthamor..... 11215                                                                                            |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 142, datë 19.7.2023  | Për shpallje ligji..... 11240                                                                                                                                                                  |
| Ligj nr. 54/2023,<br>datë 6.7.2023               | Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite për luftën kundër krimit..... 11240 |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 143, datë 19.7.2023  | Për shpallje ligji..... 11250                                                                                                                                                                  |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 58/2023, datë 13.7.2023 | Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 107/2014, ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar”..... 11250                                             |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 59/2023, datë 13.7.2023 | Për mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015, ‘Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë’” ..... 11250                                    |
| Vendim i Kuvendit<br>nr. 62/2023, datë 13.7.2023 | Për një ndryshim në vendimin nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar..... 11250                                  |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 13.7.2023            | Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2022..... 11251                                                                                                    |

|                                                             |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               |       |
|-------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 13.7.2023                       | Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2022.....                                                                                                                                                                                                                     | 11252 |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 13.7.2023                       | Për vlerësimin e veprimtarisë së Institutit të Statistikave për vitin 2022.....                                                                                                                                                                                                                                                               | 11253 |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 13.7.2023                       | Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2022.....                                                                                                                                                                                                                                                           | 11254 |
| Rezolutë e Kuvendit<br>datë 13.7.2023                       | Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022.....                                                                                                                                                                                             | 11256 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 424, datë 19.7.2023 | Për lirim nga detyra.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | 11258 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 425, datë 19.7.2023 | Për emërimin e dy anëtarëve të Këshillit Drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.....                                                                                                                                                                                                                                                   | 11258 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 427, datë 19.7.2023 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV fibër, Librazhd”.....                                                                                                                                                             | 11258 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 428, datë 19.7.2023 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ekzistuese Vlorë–Orikum dhe dy <i>by-pass</i> -eve në Radhimë, Vlorë”.....                                                                                                         | 11263 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 429, datë 19.7.2023 | Për lirim dhe emërimin në detyrë të prefektit të Qarkut Kukës.....                                                                                                                                                                                                                                                                            | 11265 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 431, datë 19.7.2023 | Për një shtesë në vendimin nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar.....                                                                                                                                                                                                        | 11265 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 432, datë 19.7.2023 | Për transferimin e pronësisë së 67.21% të aksioneve të shoqërisë “Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime” sh.a., Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Shkodër.....                                                                                                                                                   | 11265 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 433, datë 19.7.2023 | Për transferimin në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike për vënien në dispozicion të investitorit strategjik të pronës së paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8561, Bashkia Korçë, për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “ <i>Green House Korça Resort</i> ”..... | 11266 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 434, datë 19.7.2023 | Për miratimin e koeficientit të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2021 për llogaritjen e pensioneve.....                                                                                                                                                                                                                              | 11270 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 437, datë 19.7.2023 | Për shtesë fondi në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për disa institucione të pavarura, të krijuara me ligj.....                                                                                                                                                                                                                           | 11271 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 438, datë 19.7.2023 | Për miratimin e rregullave, procedurave dhe kritereve për trajtimin e punonjësve të Njësisë së Posaçme Hetimore kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.....                                                                                                                                                                             | 11272 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 440, datë 19.7.2023 | Për përcaktimin e skemës së kreditimit studentor .....                                                                                                                                                                                                                                                                                        | 11282 |

|                                                                                                                           |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                              |       |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------|
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 441, datë 19.7.2023                                                               | Për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Mira Kapisyzi .....                                                                                                                                                                                                                                                                                           | 11284 |
| Udhëzim i përbashkët i ministrit<br>të Brendshëm dhe i ministrit të<br>Financave dhe Ekonomisë<br>nr. 100, datë 20.7.2023 | Për përcaktimin e tarifave për pajisjen e shtetasve shqiptarë dhe të<br>huaj me dokumente biometrike.....                                                                                                                                                                                                                                                    | 11284 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë<br>dhe Zhvillimit Rural nr. 421,<br>datë 14.7.2023                                        | Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve<br>të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve<br>të tyre nga Serbia.....                                                                                                                                                                                         | 11285 |
| Urdhër i ministrit të Bujqësisë<br>dhe Zhvillimit Rural<br>nr. 422, datë 14.7.2023                                        | Për shfuqizimin e urdhrit nr. 27, datë 26.1.2023, “Për disa masa<br>mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të<br>lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë”.....                                                                                                                                                           | 11287 |
| Vendim i Gjykatës Kushtetuese<br>nr. 39, datë 14.7.2023                                                                   | Me objekt saktësim në vendimin nr. 28, datë 18.5.2023, të Gjykatës<br>Kushtetuese.....                                                                                                                                                                                                                                                                       | 11288 |
|                                                                                                                           | Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në Autoritetin<br>Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK).....                                                                                                                                                                                                                            | 11289 |
| Vendim i Autoritetit për<br>Informimin mbi Dokumentet<br>e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 10,<br>datë 19.7.2023             | Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH.....                                                                                                                                                                                                                                                                                                 | 11291 |
| Kërkesë e Agjencinë Shtetërore<br>për Shpronësimin nr. 411/12,<br>datë 19.7.2023                                          | Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM-në nr. 354, datë 16.6.2021,<br>“Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të<br>paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Për<br>projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës, porti i jahteve— <i>by<br/>pass</i> Orikum–Dukat (ura e Shën Elizës)’”, i ndryshuar..... | 11314 |
|                                                                                                                           | Korrigjim gabimi material në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 82,<br>datë 20.4.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë<br>“Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të<br>energjisë elektrike, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 75, datë<br>19.5.2022.....                                                               | 11317 |





**LIGJ**  
**Nr. 51/2023****PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN**  
**NR. 91/2013 “PËR VLERËSIMIN**  
**STRATEGJIK MJEDISOR”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**VENDOSI:**

Në ligjin nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor” bëhen këto ndryshime:

**Neni 1**

Në pikën 1 të nenit 10 fjalët “të licencuara nga Qendra Kombëtare e Licencimit” zëvendësohen me fjalët “të regjistruara në regjistrin tregtar me objekt veprimtarie hartimin e raporteve”.

**Neni 2**

Pika 3 e nenit 12 ndryshohet si më poshtë:

“3. Në rast se ministria konstaton të meta ose pasaktësi në dokumentet e paraqitura brenda 7 ditëve nga dita e regjistrimit të kërkesës, i kërkon autoritetit propozues plotësimin e tyre brenda 10 ditëve nga marrja e kërkesës. Në rast se autoriteti propozues nuk plotëson të metat ose pasaktësitë brenda afatit të kërkuar, kërkesa quhet se nuk është regjistruar dhe i kthehet bashkë me aktet e tjera.”.

**Neni 3**

Neni 14 ndryshohet si më poshtë:

**“Neni 14**  
**Ankimi**

Grupet e interesit, përfshi edhe publikun, kanë të drejtën e ankimit administrativ ndaj deklaratës së ministrit dhe qëndrimit të ministrisë brenda 30 ditëve nga njoftimi për nxjerrjen e deklaratës apo

qëndrimit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative.”.

**Neni 4**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 6.7.2023.

**Shpallur me dekretin nr. 144, datë 20.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

**DEKRET**  
**Nr. 144, datë 20.7.2023****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 51/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 91/2013, ‘Për vlerësimin strategjik mjedisor’”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**LIGJ**  
**Nr. 53/2023****PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS**  
**NDËRKOMBËTARE PËR SHTYPJEN**  
**E AKTEVE TË TERRORIZMIT**  
**BËRTHAMOR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**VENDOSI:****Neni 1**

Ratifikohet Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Akteve të Terrorizmit Bërthamor sipas



tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

## Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar më datë 6.7.2023.

**Shpallur me dekreten nr. 142, datë 19.7.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

## KONVENTA NDËRKOMBËTARE PËR SHTYPJEN E AKTEVE TË TERRORIZMIT BËRTHAMOR

[Emblemë]  
**KOMBET E BASHKUARA**  
**2005**

### Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Akteve të Terrorizmit Bërthamor

*Shtetet Palë të kësaj Konvente,*

*duke pasur parasysh* qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara, në lidhje me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, si dhe promovimin e fqinjësisë së mirë dhe marrëdhënieve miqësore dhe bashkëpunimit ndërmjet shteteve;

*duke kujtuar* deklaratën e datës 24 tetor 1995 me Rastin e Pesëdhjetëvjetorit të Kombeve të Bashkuara;

*duke njohur* të drejtën e të gjitha shteteve për të zhvilluar dhe aplikuar energjinë bërthamore për qëllime paqësore dhe interesat e tyre legjitimë në përfitimet e mundshme që do të rrjedhin nga aplikimi paqësor i energjisë bërthamore;

*duke pasur parasysh* Konventën për Mbrojtjen Fizike të Materialeve Bërthamore të vitit 1980;

*thellësisht të shqetësuar* për përshkallëzimin mbarëbotëror të akteve të terrorizmit në të gjitha format dhe manifestimet e tij;

*duke kujtuar* Deklaratën mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar bashkëlidhur Rezolutës 49/60 të Asamblesë së Përgjithshme të 9 dhjetorit 1994, në të cilën, ndër

të tjera, Shtetet Anëtare të Kombeve të Bashkuara rikonfirmojnë solemnisht dënimin e tyre pa mëdyshje të të gjitha akteve, metodave dhe praktikave të terrorizmit si kriminale dhe të pajustificueshme, kudo dhe nga kushdo që janë kryer, duke përfshirë ato që rrezikojnë marrëdhëniet miqësore ndërmjet shteteve dhe popujve dhe kërcënojnë integritetin territorial dhe sigurinë e shteteve;

*duke theksuar* se Deklarata, gjithashtu, i nxiti shtetet që të rishikojnë urgjentisht fushëveprimin e dispozitave ligjore ndërkombëtare ekzistuese për parandalimin, shtypjen dhe eliminimin e terrorizmit në të gjitha format dhe manifestimet e tij, me qëllim që të garantohet se ekziston një kuadër ligjor gjithëpërfshirës që mbulon të gjitha aspektet e çështjes;

*duke kujtuar* Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme 51/210 të datës 17 dhjetor 1996 dhe Deklaratën për Plotësimin e Deklaratës së vitit 1994 mbi Masat për Eliminimin e Terrorizmit Ndërkombëtar të aneksuar në të;

*duke kujtuar, gjithashtu,* se në përputhje me rezolutën 51/210 të Asamblesë së Përgjithshme, u krijua një komitet i përkohshëm për të përpunuar, ndër të tjera, një konventë ndërkombëtare për shtypjen e akteve të terrorizmit bërthamor për të plotësuar instrumentet ekzistuese ndërkombëtare përkatëse;

*duke theksuar* se aktet e terrorizmit bërthamor mund të rezultojnë në pasojat më të rënda dhe mund të përbëjnë një kërcënim për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare,

*duke theksuar, gjithashtu,* se dispozitat ligjore shumëpalëshe ekzistuese nuk i trajtojnë në mënyrë të përshtatshme këto sulme;

*duke qenë të bindur* për nevojën urgjente për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet shteteve për hartimin dhe miratimin e masave të efektshme dhe praktike për parandalimin e akteve të tilla të terrorizmit dhe për ndjekjen dhe ndëshkimin e autorëve të tyre;

*duke theksuar* se aktivitetet e forcave ushtarake të shteteve rregullohen nga rregulla të së drejtës ndërkombëtare jashtë kuadrit të kësaj Konvente dhe se përjashtimi i veprimeve të caktuara nga mbulimi i kësaj Konvente nuk pranon ose bën akte të ligjshme ndryshe të paligjshme, ose përjashton ndjekjen penale sipas ligjeve të tjera;

*kanë rënë dakord* për sa vijon:



## Neni 1

Për qëllime të kësaj Konvente:

1. “Material radioaktiv” nënkupton materialin bërthamor dhe substanca të tjera radioaktive që përmbajnë nuklide, të cilat i nënshtrohen shpërbërjes spontane (një proces i shoqëruar nga emetimi i një ose më shumë llojeve të rrezatimit jonizues, si grimcat alfa, beta, neutron dhe rrezet gama) dhe që për shkak të vetive të tyre radiologjike ose të zërthyeshme, mund të shkaktojnë vdekje, lëndime të rënda trupore ose dëme thelbësore në pronë ose në mjedis.

2. “Material bërthamor” nënkupton plutoniumin, përveç atij me përqendrim izotop që kalon 80 për qind në plutonium-238; uranium-233; uranium i pasuruar në izotopin 235 ose 233; uranium që përmban përzierjen e izotopeve që gjenden në natyrë, përveçse në formën e xeherorëve ose të mbetjeve të xeherorëve; ose çdo material që përmban një ose më shumë nga sa më sipër;

Ku “uraniumi i pasuruar në izotopin 235 ose 233” nënkupton uraniumin që përmban izotopin 235 ose 233 ose të dyja në një sasi të tillë që raporti i bollëkut të shumës së këtyre izotopeve me izotopin 238 është më i madh, sesa raporti i izotopit 235 me izotopi 238 që gjendet në natyrë.

3. “Objekt bërthamor” nënkupton:

a) Çdo reaktor bërthamor, duke përfshirë reaktorët e instaluar në anije, automjete, avionë ose objekte hapësinore për t’u përdorur si burim energjie për të shtyrë këto anije, automjete, avionë ose objekte hapësinore ose për çdo qëllim tjetër;

b) Çdo impiant ose mjet transporti që përdoret për prodhimin, ruajtjen, përpunimin ose transportin e materialit radioaktiv.

4. “Pajisje” nënkupton:

a) Çdo pajisje shpërthyes bërthamore; ose

b) Çdo pajisje për shpërndarjen e materialit radioaktiv ose që lëshon rrezatim, e cila, për shkak të vetive radiologjike, mund të shkaktojë vdekje, lëndime të rënda trupore ose dëme thelbësore në pronë ose në mjedis.

5. “Objekt shtetëror ose qeveritar” përfshin çdo objekt ose mjet transporti të përhershëm ose të përkohshëm që përdoret ose zotërohet nga përfaqësues të një shteti, anëtarë të një qeverie, legjislatura ose gjyqësori apo nga zyrtarë ose punonjës të një shteti ose çdo autoriteti ose enti

tjetër publik ose nga punonjës ose zyrtarë të një organizate ndërqeveritare, në lidhje me detyrat e tyre zyrtare.

6. “Forcat ushtarake të një shteti” nënkupton forcat e armatosura të një shteti, të cilat janë të organizuara, trajnuara dhe pajisura sipas ligjit të brendshëm për qëllimin kryesor të mbrojtjes ose sigurisë kombëtare dhe personat që veprojnë në mbështetje të atyre forcave të armatosura që janë nën komandën, kontrollin dhe përgjegjësinë e tyre zyrtare.

## Neni 2

1. Çdo person kryen një veprë penale sipas kuptimit të kësaj Konvente, nëse ai person në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme:

a) Zotëron material radioaktiv ose prodhon ose zotëron një pajisje:

i. Me qëllimin për të shkaktuar vdekje ose lëndim të rëndë trupor; ose

ii. Me qëllimin për të shkaktuar dëme thelbësore në pronë ose mjedis;

b) Përdor në çfarëdo mënyre material ose pajisje radioaktive ose përdor apo dëmton një objekt bërthamor në një mënyrë që çliron ose rrezikon çlirimin e materialit radioaktiv:

i. me qëllimin për të shkaktuar vdekje ose lëndim të rëndë trupor; ose

ii. me qëllimin për të shkaktuar dëme thelbësore në pronë ose mjedis; ose

iii. me qëllimin për të detyruar një person fizik ose juridik, organizatë ndërkombëtare ose një shtet që të bëjë ose të përmbahet nga kryerja e një akti.

2. Çdo person, gjithashtu, kryen një veprë penale nëse ai person:

a) Kërcënon, në rrethana që tregojnë besueshmërinë e kërcënimit, se do të kryejë një veprë penale siç përcaktohet në paragrafin 1 (b) të këtij neni; ose

b) Kërkon në mënyrë të paligjshme dhe të qëllimshme materiale radioaktive, një pajisje ose objekt bërthamor me kërcënim, në rrethana që tregojnë besueshmërinë e kërcënimit ose me përdorimin e forcës.

3. Çdo person kryen një veprë penale edhe nëse ai person tenton të kryejë një veprë penale të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

4. Çdo person, gjithashtu, kryen një veprë penale, nëse ai person:



a) merr pjesë si bashkëpunëtor në një veprë penale të përcaktuar në paragrafin 1, 2 ose 3 të këtij neni; ose

b) organizon ose udhëzon të tjerët që të kryejnë një shkelje të përcaktuar në paragrafin 1, 2 ose 3 të këtij neni; ose

c) në çdo mënyrë tjetër kontribuon në kryerjen e një ose më shumë veprave penale të përcaktuara në paragrafin 1, 2 ose 3 të këtij neni nga një grup personash që veprojnë, me qëllim të përbashkët; një kontribut i tillë do të jetë i qëllimshëm dhe ose do të bëhet me synimin për të zhvilluar më tej veprimtarinë e përgjithshme kriminale ose qëllimin e grupit ose do të bëhet, duke pasur dijeni për qëllimin e grupit për të kryer veprën ose veprat penale në fjalë.

### Neni 3

Kjo Konventë nuk do të zbatohet kur shkelja është kryer brenda një shteti të vetëm, shkelësi i dyshuar dhe viktimat janë shtetas të atij shteti, shkelësi i dyshuar gjendet në territorin e atij shteti dhe asnjë shtet tjetër nuk ka bazë sipas nenit 9, paragrafi 1 ose 2, për të ushtruar juridiksion, përveçse dispozitat e neneve 7, 12, 14, 15, 16 dhe 17 do të zbatohen, nëse është e përshtatshme, në ato raste.

### Neni 4

1. Asgjë në këtë Konventë nuk do të cenojë të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e tjera të shteteve dhe individëve, sipas të drejtës ndërkombëtare, në veçanti qëllimet dhe parimet e Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të drejtës ndërkombëtare humanitare.

2. Aktivitetet e forcave të armatosura gjatë një konflikti të armatosur, siç kuptohen këto terma në të drejtën ndërkombëtare humanitare, të cilat rregullohen nga ai ligj, nuk rregullohen nga kjo Konventë dhe aktivitetet e ndërmarra nga forcat ushtarake të një shteti në ushtrimin e detyrave të tyre zyrtare, në masën që rregullohen nga rregulla të tjera të së drejtës ndërkombëtare, nuk rregullohen nga kjo Konventë.

3. Dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni nuk do të interpretohen si miratim - apo kryerje të veprimeve të ligjshme ndryshe të paligjshme, apo si pengim i ndjekjes penale sipas ligjeve të tjera.

4. Kjo Konventë nuk trajton dhe as nuk mund të interpretohet se trajton, në asnjë mënyrë, çështjen e ligjshmërisë së përdorimit ose kërcënimit të përdorimit të armëve bërthamore nga shtetet.

### Neni 5

Çdo Shtet Palë do të miratojë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme:

a) Për të përcaktuar si vepra penale, sipas ligjit të tij kombëtar, veprat penale të përcaktuara në nenin 2;

b) Për t'i bërë ato vepra penale të dënueshme me penalitete të përshtatshme që marrin parasysh natyrën e rëndë të këtyre veprave.

### Neni 6

Secili Shtet Palë do të miratojë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme, duke përfshirë, sipas rastit, legjislacionin e brendshëm, për të siguruar që aktet kriminale brenda objektit të kësaj Konvente, veçanërisht kur synohen ose llogariten të provokojnë një gjendje terrori në publikun e gjerë ose në një grup personash ose persona të caktuar, në asnjë rrethanë nuk justifikohen me konsiderata të natyrës politike, filozofike, ideologjike, raciale, etnike, fetare ose të tjera të ngjashme dhe dënohen me dënime në përputhje me natyrën e tyre të rëndë.

### Neni 7

1. Shtetet Palë do të bashkëpunojnë duke:

a) marrë të gjitha masat praktike, përfshirë, nëse është e nevojshme, përshtatjen e legjislacionit të tyre kombëtar, për të parandaluar dhe kundërshtuar përgatitjet në territoret e tyre përkatëse për kryerjen brenda ose jashtë territorit të tyre të veprave të përcaktuara në nenin 2, duke përfshirë masat për të ndaluar në territoret e tyre aktivitetet e paligjshme të personave, grupeve dhe organizatave që inkurajojnë, nxisin, organizojnë, financojnë me vetëdije ose ofrojnë me vetëdije asistencë ose informacion teknik ose angazhohen në kryerjen e këtyre veprave;

b) shkëmbyer informacion të saktë dhe të verifikuar në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar dhe mënyrën dhe në bazë të kushteve të përcaktuara këtu, si dhe duke koordinuar masat administrative dhe të tjera, të marra sipas nevojës



për zbulimin, parandalimin, shtypjen dhe hetimin e veprave penale të përcaktuara në nenin 2, si dhe duke filluar procedimin penal kundër personave të dyshuar për kryerjen e këtyre krimeve. Në veçanti, një Shtet Palë do të marrë masat e duhura për të informuar pa vonesë shtetet e tjera të përmendura në nenin 9, në lidhje me kryerjen e veprave penale të parashikuara në nenin 2, si dhe përgatitjet për të kryer vepra të tilla për të cilat ai ka mësuar, si dhe për të informuar, siç është e përshtatshme, organizatat ndërkombëtare.

2. Shtetet Palë do të marrin masat e duhura në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar për të mbrojtur konfidencialitetin e çdo informacioni që ata marrin në fshehtësi, në bazë të dispozitave të kësaj Konvente nga një shtet tjetër palë ose nëpërmjet pjesëmarrjes në një aktivitet të kryer për zbatimin e kësaj Konvente. Nëse shtetet palë u japin informacion në fshehtësi organizatave ndërkombëtare, do të ndërmerren hapa për të siguruar mbrojtjen e konfidencialitetit të këtij informacioni.

3. Shteteve Palë nuk do t'u kërkohej nga kjo Konventë të japin ndonjë informacion që nuk lejohet ta komunikojnë në përputhje me legjislacionin kombëtar ose që do të rrezikonte sigurinë e shtetit në fjalë ose mbrojtjen fizike të materialit bërthamor.

4. Shtetet Palë do të informojnë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për autoritetet e tyre kompetente dhe pikat ndërlidhëse përgjegjëse për dërgimin dhe marrjen e informacionit të përmendur në këtë nen. Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara do t'ua komunikojë këtë informacion, në lidhje me autoritetet kompetente dhe pikat ndërlidhëse, të gjitha Shteteve Palë dhe Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike. Këto autoritete dhe pika ndërlidhëse duhet të jenë të aksesueshme në mënyrë të vazhdueshme.

#### Neni 8

Për qëllime të parandalimit të veprave penale sipas kësaj Konvente, Shtetet Palë do të bëjnë çdo përpjekje për të miratuar masat e duhura për të garantuar mbrojtjen e materialit radioaktiv, duke marrë parasysh rekomandimet dhe funksionet përkatëse të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike.

#### Neni 9

1. Çdo Shtet Palë do të marrë masa të tilla që mund të jenë të nevojshme për të vendosur juridiksionin e vet mbi veprat penale të përcaktuara në nenin 2, kur:

a) shkelja është kryer në territorin e atij shteti; ose

b) shkelja kryhet në bordin e një anijeje që mban flamurin e atij shteti ose në një avion i cili është i regjistruar sipas ligjeve të atij shteti në kohën kur është kryer vepra; ose

c) shkelja është kryer nga një shtetas i atij shteti.

2. Një Shtet Palë mund të vendosë gjithashtu juridiksionin e tij mbi çdo veprë të tillë, kur:

a) shkelja është kryer kundër një shtetasi të atij shteti; ose

b) shkelja është kryer kundër një shteti ose objekti qeveritar të atij shteti jashtë vendit, duke përfshirë një ambasadë ose objekte të tjera diplomatike ose konsullore të atij shteti; ose

c) shkelja kryhet nga një person pa shtetësi, i cili ka vendbanimin e tij ose të saj të zakonshëm në territorin e atij shteti; ose

d) shkelja është kryer në përpjekje për ta detyruar atë shtet të kryejë ose të përmbahet nga kryerja e çdo veprimi; ose

e) shkelja është kryer në bordin e një avioni që operohet nga qeveria e atij shteti.

3. Me ratifikimin, pranimin, miratimin ose aderimin në këtë Konventë, çdo Shtet Palë do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për juridiksionin që ka vendosur sipas ligjit të tij kombëtar, në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni. Nëse ndodh ndonjë ndryshim, shteti palë në fjalë do të njoftojë menjëherë Sekretarin e Përgjithshëm.

4. Çdo Shtet Palë do të marrë, gjithashtu, masa të nevojshme për të vendosur juridiksionin e vet mbi veprat penale të përcaktuara në nenin 2, në rastet kur shkelësi i dyshuar është i pranishëm në territorin e tij dhe ai nuk e ekstradon atë person te ndonjë prej Shteteve Palë që kanë vendosur juridiksionin e tyre në pajtim me paragrafin 1 ose 2 të këtij neni.

5. Kjo Konventë nuk përjashton ushtrimin e ndonjë juridiksioni penal të krijuar nga një Shtet Palë në përputhje me legjislacionin e tij kombëtar.



## Neni 10

1. Me marrjen e informacionit se është kryer ose po kryhet një veprë penale e përcaktuar në nenin 2 në territorin e një Shteti Palë ose që një person që ka kryer ose që dyshohet se ka kryer një veprë të tillë mund të jetë i pranishëm në territorin e tij, Shteti Palë i interesuar do të marrë masat e nevojshme sipas legjislacionit kombëtar për të hetuar faktet e përfshira në informacion.

2. Pasi të bindet se rrethanat e justifikojnë këtë, Shteti Palë në territorin e të cilit është i pranishëm shkelësi apo shkelësi i dyshuar, do të marrë masat e duhura sipas ligjit kombëtar për të siguruar praninë e atij personi me qëllim ndjekjeje ose ekstradimi.

3. Çdo person ndaj të cilit merren masat sipas paragrafit 2 të këtij neni, ka të drejtë:

a) të komunikojë pa vonesë me përfaqësuesin e duhur më të afërt të shtetit i të cilit ai person është shtetas ose që ka të drejtë të mbrojtë të drejtat e atij personi ose, nëse ai person është person pa shtetësi, me shtetin në territorin e të cilit ai person ka vendbanim të zakonshëm;

b) të vizitohet nga një përfaqësues i atij shteti;

c) të informohet për të drejtat e atij personi sipas nënparagrafëve “a” dhe “b”.

4. Të drejtat e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni do të ushtrohen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e shtetit në territorin e të cilit është i pranishëm shkelësi ose shkelësi i dyshuar, në bazë të dispozitave që ligjet dhe rregulloret e përmendura duhet të mundësojnë dhënien e efektit të plotë, për qëllimet për të cilat synohen të drejtat e dhëna sipas paragrafit 3.

5. Dispozitat e paragrafëve 3 dhe 4 të këtij neni nuk do të cenojnë të drejtën e ndonjë Shteti Palë që ka pretendim për juridiksion në përputhje me nenin 9, paragrafi 1(c) ose 2(c), për të ftuar Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për të komunikuar dhe vizituar shkelësin e dyshuar.

6. Kur një Shtet Palë, në përputhje me këtë nen, ka marrë një person në paraburgim, ai do të njoftojë menjëherë, drejtpërdrejt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Shtetet Palë që kanë vendosur juridiksionin në përputhje me nenin 9, paragrafi 1 dhe 2 dhe nëse e çmon të këshillueshme, çdo Shtet tjetër Palë të interesuar, për faktin që ai person është në paraburgim dhe për rrethanat që justifikojnë ndalimin e atij personi. Shteti që kryen

hetimin e parashikuar në paragrafin 1 të këtij neni, do të informojë menjëherë Shtetet Palë në fjalë për gjetjet e tij dhe do të specifikojë nëse synon të ushtrojë juridiksion.

## Neni 11

1. Shteti Palë në territorin e të cilit është i pranishëm shkelësi i dyshuar, në rastet në të cilat zbatohet neni 9, nëse nuk e ekstradon atë person, do të jetë i detyruar, pa asnjë përjashtim dhe nëse vepra është kryer apo jo në territorin e tij, t’ia paraqesë çështjen pa vonesa të panevojshme autoriteteve të veta kompetente për qëllime të ndjekjes penale, nëpërmjet procedimeve në përputhje me ligjet e atij shteti. Këto autoritete do të marrin vendimin e tyre në të njëjtën mënyrë si në rastin e çdo veprë tjetër penale të një natyre të rëndë sipas ligjit të atij shteti.

2. Sa herë që një Shtet Palë i lejohet sipas legjislacionit kombëtar të ekstradojë ose ndryshe të dorëzojë një nga shtetasit e tij vetëm me kushtin që personi të kthehet në atë shtet për të kryer dënimin e vendosur si rezultat i gjykimit ose procedimit për të cilin është kërkuar ekstradimi ose dorëzimi i personit dhe ky shtet dhe shteti që kërkon ekstradimin e personit bien dakord me këtë opsion dhe me kushte të tjera që mund t’i çmojnë të përshtatshme, një ekstradim ose dorëzim i tillë me kusht do të jetë i mjaftueshëm për të përmbushur detyrimin e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni.

## Neni 12

Çdo personi që mbahet në paraburgim ose në lidhje me të cilin është marrë ndonjë masë tjetër ose kryhet procedim në përputhje me këtë Konventë, do t’i garantohet trajtim i drejtë, duke përfshirë gëzimin e të gjitha të drejtave dhe garancive në përputhje me ligjin e shtetit në territorin e të cilit ai person është i pranishëm dhe zbatimin e dispozitave të së drejtës ndërkombëtare, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## Neni 13

1. Veprat penale të përcaktuara në nenin 2 do të konsiderohen se përfshihen si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që



ekziston midis çdo një prej Shteteve Palë përpara hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Shtetet Palë marrin përsipër të përfshijnë vepra të tilla si vepra të ekstradueshme në çdo traktat ekstradimi që do të lidhet më pas ndërmjet tyre.

2. Kur një Shtet Palë që e kushtëzon ekstradimin me ekzistencën e një traktati merr një kërkesë për ekstradim nga një Shtet tjetër Palë me të cilin nuk ka traktat ekstradimi, Shteti Palë i kërkuar, sipas zgjedhjes së tij, mund ta konsiderojë këtë Konventë si bazë ligjore për ekstradimin në lidhje me veprat e parashikuara në nenin 2. Ekstradimi do t'u nënshtrohet kushteve të tjera të parashikuara nga ligji i shtetit të kërkuar.

3. Shtetet Palë, të cilat nuk e kushtëzojnë ekstradimin me ekzistencën e një traktati, do t'i njohin krimet e parashikuara në nenin 2 si vepra të ekstradueshme ndërmjet tyre, në bazë të kushteve të parashikuara nga ligji i shtetit të kërkuar.

4. Nëse është e nevojshme, veprat e parashikuara në nenin 2 do të trajtohen, për qëllime të ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë, sikur të ishin kryer jo vetëm në vendin ku kanë ndodhur, por edhe në territorin e shteteve që kanë vendosur juridiksionin në përputhje me nenin 9, paragrafët 1 dhe 2.

5. Dispozitat e të gjitha traktateve dhe marrëveshjeve të ekstradimit ndërmjet Shteteve Palë në lidhje me veprat penale të përcaktuara në nenin 2, do të konsiderohen të modifikuara midis Shteteve Palë në masën që janë të papajtueshme me këtë Konventë.

#### Neni 14

1. Shtetet Palë do t'i japin njëri-tjetrit masën më të madhe të ndihmës në lidhje me hetimet, procedurat penale ose të ekstradimit të paraqitura, në lidhje me veprat penale të përcaktuara në nenin 2, duke përfshirë ndihmën për marrjen e provave në dispozicion të tyre, të nevojshme për procedurën.

2. Shtetet Palë do të përmbushin detyrimet e tyre sipas paragrafit 1 të këtij neni në përputhje me çdo traktat ose marrëveshje tjetër për ndihmën e ndërsjellë juridike që mund të ekzistojë ndërmjet tyre. Në mungesë të traktateve ose marrëveshjeve të tilla, Shtetet Palë do t'i ofrojnë njëri-tjetrit ndihmë në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar.

#### Neni 15

Asnjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 2 nuk do të konsiderohet, për qëllime ekstradimi ose të ndihmës juridike të ndërsjellë, si vepër politike ose si vepër e lidhur me një vepër politike ose si vepër e frymëzuar nga motive politike. Si rrjedhojë, një kërkesë për ekstradim ose ndihmë të ndërsjellë juridike, bazuar në një vepër të tillë penale, nuk mund të refuzohet vetëm me arsyetimin se lidhet me një vepër politike ose vepër penale të lidhur me një vepër politike ose vepër të frymëzuar nga motive politike.

#### Neni 16

Asgjë në këtë Konventë nuk do të interpretohet si vendosje e një detyrimi për të ekstraduar ose për të ofruar ndihmë të ndërsjellë juridike, nëse Shteti Palë i kërkuar ka arsye thelbësore për të besuar se kërkesa për ekstradim për veprat penale të parashikuara në nenin 2 ose për ndihmë të ndërsjellë juridike në lidhje me këto vepra penale, është bërë me qëllim të ndjekjes ose dënimit të një personi për shkak të racës, fesë, kombësisë, origjinës etnike ose opinionit politik të atij personi ose që përmbushja e kërkesës do të shkaktojë cenim të pozicionit të atij personi për ndonjë nga këto arsye.

#### Neni 17

1. Një person i cili është i ndaluar ose është duke kryer një dënim në territorin e një Shteti Palë, prania e të cilit në një Shtet tjetër Palë kërkohet për qëllime të dëshmisë, identifikimit ose dhënies së ndihmës për marrjen e provave për hetimin ose ndjekjen penale të veprave sipas kësaj Konvente, mund të transferohet nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) personi jep lirisht pëlqimin e tij ose të saj të informuar; dhe

b) autoritetet kompetente të të dy shteteve bien dakord, në bazë të kushteve që këto shtete mund t'i çmojnë të përshtatshme.

2. Për qëllimet e këtij neni:

a) shteti në të cilin personi transferohet, do të ketë autoritetin dhe detyrimin për ta mbajtur personin e transferuar në paraburgim, përveç rastit



kur kërkohet ose autorizohet ndryshe nga shteti nga i cili është transferuar personi;

b) Shteti në të cilin personi transferohet, do të zbatojë pa vonesë detyrimin e tij për ta kthyer personin nën ndalimin e shtetit nga i cili është transferuar personi, siç është rënë dakord më parë, ose siç është rënë dakord ndryshe, nga autoritetet kompetente të të dyja shteteve;

c) Shteti në të cilin personi transferohet nuk do të kërkojë nga shteti nga i cili është transferuar personi, të fillojë procedurat e ekstradimit për kthimin e personit;

d) Personi i transferuar do të marrë ulje për kryerjen e dënimit në shtetin nga i cili është transferuar për kohën e kaluar në paraburgim të shtetit në të cilin ai ose ajo është transferuar.

3. Me përjashtim të rastit kur shteti palë nga i cili do të transferohet një person në përputhje me këtë nen bie dakord, ai person, pavarësisht nga shtetësia e tij ose saj, nuk do të ndiqet penalisht, as do të ndalohet e as nuk do të nënshtrohet ndonjë kufizimi tjetër të lirisë së tij/saj personale në territorin e shtetit në të cilin ai person është transferuar, në lidhje me aktet ose dënimet para largimit të tij ose të saj nga territori i shtetit nga i cili është transferuar ky person.

#### Neni 18

1. Pas konfiskimit ose ndryshe marrjes së kontrollit të materialit radioaktiv, pajisjeve ose objekteve bërthamore, pas kryerjes së një vepre penale të përcaktuar në nenin 2, Shteti Palë që zotëron këto sende, do të:

a) ndërmarrë hapa për ta bërë të padëmshëm materialin radioaktiv, pajisjen ose objektin bërthamor;

b) sigurojë që çdo material bërthamor të mbahet në përputhje me masat mbrojtëse të zbatueshme të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike; dhe

c) ketë parasysh rekomandimet e mbrojtjes fizike dhe standardet e shëndetit dhe sigurisë të publikuara nga Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike.

2. Pas përfundimit të çdo procedimi lidhur me një vepër penale të përcaktuar në nenin 2 ose më herët, nëse kërkohet nga ligji ndërkombëtar, çdo material radioaktiv, pajisje ose objekt bërthamor do të kthehet, pas konsultimeve (në veçanti, në lidhje

me mënyrën e kthimit dhe ruajtjes) me Shtetet Palë të interesuara tek Shteti Palë të cilit i përket, te Shteti Palë të cilit personi fizik ose juridik që zotëron një material, pajisje ose objekt të tillë radioaktiv është shtetas ose rezident ose shteti palë nga territori i të cilit është vjedhur ose ndryshe marrë në mënyrë të kundërligjshme.

3. a) Kur një Shtet Palë është i ndaluar nga ligji kombëtar ose ndërkombëtar të kthejë ose pranojë një material të tillë radioaktiv, pajisje ose objekt bërthamor ose kur Shtetet Palë të interesuara bien dakord për këtë, në zbatim të paragrafit 3(b) të këtij neni, shteti palë që zotëron materialin radioaktiv, pajisjet ose objektet bërthamore, do të vazhdojë të ndërmarrë hapat e përshkruar në paragrafin 1 të këtij neni; materiale të tilla radioaktive, pajisje ose objekte bërthamore do të përdoren vetëm për qëllime paqësore;

b) Kur nuk është e ligjshme që Shteti Palë që zotëron material radioaktiv, pajisje ose objekte bërthamore t'i zotërojë ato, ai shtet do të sigurojë që ato të vihen sa më shpejt të jetë e mundur në zotërimin e një shteti për të cilin një zotërim i tillë është i ligjshëm dhe i cili, sipas rastit, ka dhënë garanci në përputhje me kërkesat e paragrafit 1 të këtij neni në konsultim me atë shtet, me qëllimin për ta bërë atë të padëmshëm; materiale të tilla radioaktive, pajisje ose objekte bërthamore do të përdoren vetëm për qëllime paqësore.

4. Nëse materiali radioaktiv, pajisjet ose objektet bërthamore të përmendura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni nuk i përkasin ndonjë prej Shteteve Palë ose një shtetasi ose rezidenti të një shteti palë ose nuk janë vjedhur ose përfutur në mënyrë të paligjshme nga territori i një Shteti Palë ose nëse asnjë shtet nuk është i gatshëm të marrë sende të tilla në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, një vendim i veçantë në lidhje me disponimin e tij, në zbatim të paragrafit 3 (b) të këtij neni, do të merret pas konsultimeve ndërmjet shteteve të interesuara dhe çdo organizate ndërkombëtare përkatëse.

5. Për qëllimet e paragrafëve 1, 2, 3 dhe 4 të këtij neni, Shteti Palë që zotëron materialin radioaktiv, pajisjen ose objektin bërthamor, mund të kërkojë ndihmën dhe bashkëpunimin e Shteteve të tjera Palë, në veçanti të Shteteve Palë të interesuara dhe çdo organizate ndërkombëtare përkatëse, në veçanti të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike. Shtetet Palë dhe organizatat ndërkombëtare përkatëse nxiten të ofrojnë ndihmë





sipas këtij paragrafi në masën maksimale të mundshme.

6. Shtetet Palë të përfshira në asgjësimin ose mbajtjen e materialit radioaktiv, pajisjes ose objektit bërthamor në përputhje me këtë nen, do të informojnë drejtorin e përgjithshëm të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, për mënyrën në të cilën është asgjësuar ose mbajtur një artikull i tillë. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike do t'ua transmetojë informacionin Shteteve të tjera Palë.

7. Në rast të ndonjë shpërndarjeje në lidhje me një vepër penale të përcaktuar në nenin 2, asgjë në këtë nen nuk do të ndikojë në asnjë mënyrë të rregullat e së drejtës ndërkombëtare që rregullojnë përgjegjësinë për dëmtimin bërthamor ose rregulla të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

#### Neni 19

Shteti Palë ku shkelësi i dyshuar ndiqet penalisht, në përputhje me legjislacionin kombëtar ose procedurat e zbatueshme, do t'ia komunikojë rezultatin përfundimtar të procedurës Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili do t'ua transmetojë informacionin Shteteve të tjera Palë.

#### Neni 20

Shtetet Palë kryejnë konsultime me njëri-tjetrin drejtpërdrejt ose nëpërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, me asistencën e organizatave ndërkombëtare sipas nevojës, për të garantuar zbatimin e efektshëm të kësaj Konvente.

#### Neni 21

Shtetet Palë do të përmbushin detyrimet e tyre sipas kësaj Konvente në një mënyrë që të jetë në përputhje me parimet e barazisë sovrane dhe integritetit territorial të shteteve dhe atë të mosndërhyrjes në punët e brendshme të shteteve të tjera.

#### Neni 22

Asgjë në këtë Konventë nuk i jep të drejtë një Shteti Palë të ndërmarrë në territorin e një Shteti

tjetër Palë, ushtrimin e juridiksionit dhe kryerjen e funksioneve të cilat janë të rezervuara ekskluzivisht për autoritetet e atij Shteti tjetër Palë nga legjislacioni i tij kombëtar.

#### Neni 23

Nënshkruar në Riad, Arabia Saudite, më 21.2.2023, në dy kopje, në gjuhët shqipe, arabe, dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast të mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

**Për Këshillin e  
Ministrave  
të Republikës  
së Shqipërisë**

**Për Qeverinë e  
Mbretërisë  
së Arabisë Saudite**



## COOPERATION AGREEMENT

BETWEEN

THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF ALBANIA

AND

THE GOVERNMENT OF THE KINGDOM OF SAUDI ARABIA ON

### COMBATING CRIME

The Council of Ministers of the Republic of Albania and The Government of the Kingdom of Saudi Arabia (hereinafter referred to as the "Parties");

Seeking to strengthen existing friendship and cooperation ties between the Parties;

Wishing to establish and strengthen further cooperation aimed at preventing and combating crime;

Recognizing the mutual benefits of such cooperation;

Affirming their respect for international commitments and respective national legislations based on reciprocity; and

Respecting their national sovereignty;

**Have agreed as follows:**

#### Article 1

##### Scope of Cooperation

The Parties agree to cooperate in combating all forms of crime, especially the following:

- 1- Terrorism and its financing.



- 2- Crimes against the State.
- 3- Transnational organized crime.
- 4- Crimes relating to narcotics, psychotropic substances, and precursor chemicals and illicit trading thereof.
- 5- Financial and economic crimes.
- 6- Money laundering crimes.
- 7- Corruption.
- 8- Fraud.
- 9- Forgery and counterfeiting of currency.
- 10- Theft or smuggling of means of transport, or the illicit trading therein.
- 11- Theft or smuggling of firearms, ammunition, or explosives, or the illicit trading therein. Theft or smuggling of radioactive, nuclear, bacterial, biological, or chemical materials, or the illicit trading therein.
- 12- Crimes against persons or property.
- 13- Trafficking in persons.
- 14- Illegal crossing of national borders or any support therein.
- 15- Trafficking, theft, or smuggling of antiquities, and items of historical, cultural, or artistic value, or the illicit trading therein.
- 16- Cybercrimes.
- 17- Theft or smuggling of precious metals or items or gemstones, or the illicit trading therein.
- 18- Environmental crimes.

## Article 2

### Methods of Cooperation

The Parties shall cooperate in combating the crimes stipulated in this Agreement through the following means and procedures:

- 1- Each Party shall notify the other Party of any available information on any criminal activity targeting the other Party, whether committed or being plotted, in the territory of either Party or that of a third Party.
- 2- Application of controlled delivery between the Parties in cases relating to narcotics, psychotropic substances, and chemical precursors.
- 3- Search for wanted persons and exchange of information and personal data of individuals suspected of committing any of the crimes referred on article 1, including financial and banking information, upon provision of justification, therefore.
- 4- Expeditionary exchange of information on terrorist individuals, groups, or organizations, especially information regarding their structure, activities, sources of funding, and means of communication.
- 5- Assessment of threats posed by crimes of terrorism and terrorism financing, organized crimes, crimes relating to narcotics and psychotropic substances





- and chemical precursors, and the updating of information related thereto to establish mechanisms to prevent and combat such crimes.
- 6- Exchange of information and expertise pertaining to the protection of means of transport and passengers.
  - 7- Exchange of information and expertise pertaining to any new means and techniques of committing crimes as well as methods of combating them.
  - 8- Exchange of laws, regulations, and publications relating to crime combating issued by the competent agencies of the Parties.
  - 9- Exchange of names of persons convicted of serious crimes committed against the other Party, as well as names of persons provisionally detained for serious crimes committed by citizens of the other Party.
  - 10- The Parties may, upon mutual agreement, cooperate in other security fields, provided that such cooperation is consistent with the purposes of this Agreement.

### **Article 3**

#### **Notices**

If either Party detains a citizen of the other Party for any of the crimes provided for in this Agreement, the competent agency of the detaining or arresting Party shall as soon as possible notify the state of the detained or arrested person.

### **Article 4**

#### **Exchange of Training**

The Parties shall cooperate in security training through the following:

- 1- Training programs and courses.
- 2- Exchange of meetings and visits.
- 3- Conferences, exhibitions, and seminars.
- 4- Exchange of available illustrative and training aids.

### **Article 5**

#### **Refusal of cooperation**

Either Party may refuse to execute the cooperation stipulated in this Agreement, wholly or partially, if such cooperation:

- 1- Undermines its sovereignty or security;
- 2- Conflicts with its national laws and international treaty obligations ;
- 3- Jeopardizes its investigations or proceedings; or





- 4- Conflicts with a judicial proceeding carried out in its territory.

#### **Article 6**

##### **Confidentiality**

- 1- The Parties shall maintain the confidentiality of information exchanged under this Agreement.
- 2- Information shall be limited to the purposes for which it was provided, and neither Party may transfer or pass it to a third Party without the written consent of the providing Party.
- 3- The parties, who are made aware of the processed data, are obliged to maintain confidentiality even after the end of the term of implementation of this agreement".
- 4- If any Party needs to use such obtained information or documents for the purposes of investigation in the framework of a criminal or judicial proceeding, it must thus proceed with a request for mutual legal assistance in compliance with international treaties and national legal obligations.

#### **Article 7**

##### **Applicable Law**

The Parties shall cooperate in the fields stipulated in this Agreement in accordance with their respective national laws. This Agreement shall not prejudice the rights and obligations arising from the bilateral or multilateral international treaties to which they are Party.

#### **Article 8**

##### **Settlement of Disputes**

Disputes arising from the interpretation, application, or implementation of this Agreement shall be settled only through direct communication between the Parties. If no agreement is reached, such disputes shall be settled through diplomatic channels.



## Article 9

### Expenses

Expenses relating to the implementation of this Agreement shall be borne by the Party on whose territory the expenses were incurred unless the Parties agree otherwise.

## Article 10

### Contact Points

- 1- In order to facilitate the implementation of this Agreement, the Parties shall establish the following contact points:
  - For the Government of the Kingdom of Saudi Arabia: (The Ministry of Interior and the Presidency of State Security).
  - For the Council of Ministers of the Republic of Albania: (The Ministry of Interior).
- 2- Each Party shall notify the other Party through diplomatic channels of any change to its contact Points.
- 3- The direct contact persons/department including the means of communication shall be exchanged in writing to facilitate cooperation in areas covered by this Agreement.
- 4- The communication between Parties shall be in English.

## Article 11

### Joint Committee

The Parties may, if necessary, form a Joint Committee of representatives from both countries in charge of and with expertise in combating crime and training in security fields to be entrusted with discussing the manner of cooperation in the fields of security in both countries, proposing necessary recommendations for the enhancement of this Agreement, and submitting them to the competent agencies of the Parties. The Joint Committee may, if necessary, meet alternately in the two countries upon the request of either Party.

**Article 12****Final Provisions**

- 1- This Agreement shall enter into force as of the date of the last notification exchanged between the Parties, through diplomatic channels, confirming the completion of the necessary internal legal procedures.
- 2- This Agreement may be amended by mutual written agreement. The amendments made shall enter into force in accordance with the procedure provided for in paragraph (1) of this Article.
- 3- This Agreement shall, upon its entry into force, be deemed valid for an indefinite period, unless either Party expresses its desire to terminate it pursuant to a written notification submitted to the other Party through diplomatic channels at least six months prior to the date set for termination. Such termination shall not affect the requests submitted during the validity of the Agreement.

Done in the City of Riyadh, Saudi Arabia... on **21. /02/2023** in duplicates, in the Albanian, Arabic, and English languages, all being equally authentic. In case of divergence of interpretation, the English text shall prevail.

**For the Council of Ministers of the  
Republic of Albania**

**For the Government of  
the Kingdom of Saudi Arabia**

**DEKRET**  
**Nr. 143, datë 19.7.2023****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 54/2023, “Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbretërisë së Arabisë Saudite për luftën kundër krimit”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË**  
**Bajram Begaj**

**VENDIM**  
**Nr. 58/2023****PËR MOSMIRATIMIN E  
PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA  
NË LIGJIN NR. 107/2014, ‘PËR  
PLANIFIKIMIN DHE ZHVILLIMIN  
E TERRITORIT’, TË NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 38, pika 6, e 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 107/2014, ‘Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit’, të ndryshuar”, nismë deputeti.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Lindita Nikolla**

Miraturar më datë 13.7.2023.

**VENDIM**  
**Nr. 59/2023****PËR MOSMIRATIMIN E  
PROJEKTLIGJIT “PËR DISA SHTESA  
DHE NDRYSHIME NË LIGJIN  
NR. 55/2015, ‘PËR INVESTIMET  
STRATEGJIKE NË REPUBLIKËN  
E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, e 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 38, pika 6, e 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 55/2015, ‘Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë’”, nismë deputeti.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE**  
**Lindita Nikolla**

Miraturar më datë 13.7.2023.

**VENDIM**  
**Nr. 62/2023****PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN  
NR. 70/2021, “PËR CAKTIMIN  
E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË  
PËRBËRJEN E KOMISIONEVE  
TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”,  
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, si dhe neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

I. Në pikën II të vendimit nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e



komisioneve të përhershme të Kuvendit”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshim:

“Deputetja Merita Bakiu largohet si anëtare zëvendësuese në Komisionin për Çështjet Evropiane”.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE  
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 13.7.2023.

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2022

#### Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur përgjegjësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, mbikëqyrjen e veprimtarive të administratës zgjedhore, monitorimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore, institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidhjen në rrugë administrative të kërkesave ose të ankesave që kanë lidhje me procesin zgjedhor;

**Vlerëson veprimtarinë e KQZ-së gjatë vitit 2022, lidhur me:**

Veprimtarinë e administratës zgjedhore dhe administrimin e dokumentacionit zgjedhor për dy procese zgjedhore: për zgjedhjet e përgjithshme për Kuvend të datës 25 prill 2021 dhe për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie në bashkitë Durrës, Shkodër, Lushnjë, Dibër, Vorë e Rrogozhinë, të zhvilluara në datën 6 mars 2022;

Hapjen e kutive dhe përpunimin e materialeve zgjedhore me vendimin nr. 3, datë 22.1.2022, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021;

Organizimin dhe administrimin e procesit të zgjedhjeve të datës 6 mars 2022;

Administrimin e kërkesave ankimore në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve;

Miratimin e vendimeve nga Komisioni Rregullator;

Miratimin e akteve nënligjore nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në funksion të organizimit

dhe të administrimit të procesit të zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 mars 2022;

Administrimin e denoncimeve nga KQZ-ja gjatë zgjedhjeve të pjesshme të datës 6 mars 2022 për të cilat Komisioneri ka miratuar 30 vendime;

Verifikimin e formularëve të vetëdeklarimit për kandidatët për kryetar bashkie, si rezultat i zgjedhjeve të pjesshme vendore të datës 6 mars 2022;

Trajnimin e administratës zgjedhore, si dhe të aktorëve të tjerë që përfshihen në një proces zgjedhor;

Miratimin e programit të detajuar me vendimin nr. 24 të datës 27 janar 2022 të KQZ-së për informimin, edukimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve, në të cilin u përfshinë të gjitha kategoritë e zgjedhësve, të rinjtë, votues për herë të parë, gratë, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat kombëtare;

Miratimin nga KQZ-ja të modelit të dhomës së fshehtë (PAK), shabllonin (fleta e votimit) për personat e verbër;

Procesin e këqyrjes paszgjedhore nga administrata e KQZ-së nga data 21.4.2022–22.4.2022, me qëllim verifikimin e rregullsisë dhe saktësisë së veprimtarisë së administratës zgjedhore (KQV dhe GN) përgjatë administrimit të procesit të votimit, si dhe veprimeve të grupeve të numërimit të votave për procesin e vlerësimit dhe numërimit të votave;

Realizimin e buxhetit të vënë në dispozicion për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 mars 2022, në masën 96.3%;

Përdorimin e Sistemit Elektronik të Identifikimit të Votuesve nëpërmjet Pajisjeve Elektronike të Identifikimit në të 6 bashkitë ku u zhvilluan zgjedhjet;

Zbatimin e projektit pilot për procesin e votimit dhe numërimit elektronik të votave për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 mars 2022 në Bashkinë Vorë, qarku Tiranë, në 44 qendra votimi, me anë të vendimit nr. 48 datë 10.2.2022 të KQZ-së;

Auditimin e fondeve të partive politike (për vitin kalendarik 2021);

Auditimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021;

Auditimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 mars 2022;





Procesin e shpërndarjes së fondeve vjetore si ndihmë financiare për partitë politike për vitin 2022;

Plotësimin e vakancave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të krijuara gjatë vitit 2022;

Plotësimin e vakancave të kandidatëve për anëtarë në këshillin bashkiak, të krijuara gjatë vitit 2022;

Realizimin e buxhetit të vënë në dispozicion për vitin 2022 në masën 95%;

Përpjekjet e KQZ-së për të mundësuar votimin nga jashtë vendit, duke organizuar një konferencë kombëtare, duke ngritur një grup pune përgjegjës për hartimin e akteve nënligjore normative, që do të përcaktojë rregullat dhe procedurat e detajuara, të cilat do të mundësojnë votimin nga jashtë vendit etj.;

Përgatitjen e një plani strategjik për përmirësimin e funksionimit të KQZ-së, me qëllim realizimin e zgjedhjeve më të mira, me mbështetjen e Këshillit të Evropës;

Aktivitetet e realizuara me organizata partnere dhe ndërkombëtare;

Marrjen e masave gjatë 6-mujorit të dytë të 2022 për organizimin e zgjedhjeve vendore të vitit 2023, me qëllim identifikimin e akteve nënligjore dhe përmirësimin e tyre;

Procesin e rekrutimit të personelit të përkohshëm dhe kontraktimin e shërbimeve të specializuara;

Planifikimin e trajnimeve të administratës zgjedhore;

Përpjekjet për digjitalizimin e proceseve të punës.

**Kuvendi rekomandon që KQZ-ja për vitin 2023 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

1. Të zbatohet Manuali i Monitorimit Vjetor dhe Periodik, i miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 134/2018, në të gjitha pikat e tij;

2. Të paraqesë pranë Kuvendit një raport të detajuar për mbarëvajtjen e procesit zgjedhor për zgjedhjet e datës 14.5.2023, duke përfshirë këtu edhe procesin e votimit elektronik, identifikimin elektronik, si dhe të gjithë infrastrukturën teknologjike të përdorur gjatë procesit zgjedhor;

3. Të bashkëpunojë me institucionet përkatëse, përfshirë këtu edhe Kuvendin e Shqipërisë, në vijim të përpjekjeve të ndërmarra gjatë vitit 2022, lidhur me miratimin e akteve nënligjore në zbatim

të Kodit Zgjedhor, për të mundësuar votimin e shtetasve shqiptarë, të cilët banojnë jashtë vendit;

4. Të paraqesë në Kuvend raportet e auditimit për raportimin financiar vjetor të partive politike dhe për financimin e partive politike për fushatat zgjedhore, siç është kërkuar edhe në rezolutën e Kuvendit të datës 21.7.2022, “Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2021”, si edhe për vitin 2022.

KRYETARE

**Lindita Nikolla**

Miratuar më datë 13.7.2023.

## REZOLUTË

### **PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR VITIN 2022**

#### **Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit në përmbushje të misionit të tij për dhënien e informacionit mbi dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në mënyrë që të edukojë publikun e të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetës, pajtimin e përgjegjësinë për brezat e ardhshëm;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medias në kohë dhe me cilësi;

Duke njohur bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendëse dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës lidhur me objektin e punës së Autoritetit;

**Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit gjatë vitit 2022, në drejtim të:**

Nënshkrimit të marrëveshjes me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për garantimin dhe realizimin e një procesi të rregullt ligjor të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të zhdukurve gjatë periudhës së komunizmit;

Krijimit dhe plotësimit të regjistrit elektronik të kërkesave dhe të përgjigjeve për të drejtën e informimit, si një sistem që mundëson qasje më të



drejtpërdrejtë të qytetarëve dhe të grupeve të interesit në informacionin publik;

Mbështetjes shkencore nëpërmjet përpunimit të kërkesave të studiuesve dhe medias për qëllime studimore dhe vënien në dispozicion të dokumentacionit arkivor të kërkuar.

Edukimit qytetar për veprimtarinë e ish-Sigurimit të Shtetit nëpërmjet projekteve studimore dhe audiovizuale, ekspozitave, konferencave dhe takimeve të Autoritetit me partnerë dhe publikun e interesuar;

Bashkëpunimit institucional me homologë të ndryshëm për shkëmbimin e përvojave me vende të cilat prezantojnë modelin më të mira në shërbim të pajtimit, paqes dhe ndërtimit të Kujtesës Evropiane;

**Kuvendi rekomandon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2023 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

1. Të hartojë aktet nënligjore në kuadër të përafrimit me ndryshimet që pësoi ligji nr. 45/2015, “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, i ndryshuar;

2. Të raportojë për përfundimet dhe pengesat ligjore që ka hasur Autoriteti gjatë zbatimit të ligjit nr. 45/2015, lidhur me verifikimin e figurave të zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie figure. Pas ndryshimeve ligjore që sollën shfuqizimin e komisioneve “Bezhan” e “Mezini”, Autoriteti të bashkëpunojë me institucionet kushtetuese dhe autoritetet publike, me qëllim që t’i drejtohen Autoritetit me kërkesë për riverifikim të figurës së zyrtarëve të pajisur më parë me certifikatë pastërtie;

3. Të vijojë punën me ndërtimin e databazës së detajuar për personat e zhdukur, e cila do të shërbejë si Regjistër i Personave të Zhdukur për nisjen e procesit të identifikimit dhe rikuperimit, si dhe për krijimin e databazës së ADN-së së të afërmeve të personave të zhdukur;

4. Të vijojë me informimin e studiuesve dhe medieve të interesuara për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, si dhe garantimin e shqyrtimit dhe të dorëzimit të dublikatave të tyre të kërkuar brenda afateve kohore të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit organik nr. 45/2015, i ndryshuar;

5. Të sistemojë dhe të vijojë me procesin e digjitalizimit të dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit të mbledhura nga institucionet arkivore në vend në arkivin e vetëm të Autoritetit;

6. Të përmirësojë procedurat e brendshme për trajtimin e kërkesave individuale, institucionale, studimore dhe qytetare, me qëllim shkurtimin e afateve kohore të shërbimit të dokumentacionit;

7. Të bashkëpunojë me Institutin e Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri dhe t’i krijojë lehtësira në punën e tij për të përmbushur detyrimet që burojnë nga neni 5 i ligjit nr. 10 242, datë 25.2.2010, “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri”, në masën dhe për qëllimet që lejon neni 26 i ligjit nr. 45/2015, i ndryshuar;

8. Të bëjë transparencën e vendimmarrjes në raportimin vjetor, ku të pasqyrohet mendimi kundër në rastet e vendimmarrjes jounanime.

KRYETARE  
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 13.7.2023.

## REZOLUTË

### PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSTITUTIT TË STATISTIKAVE PËR VITIN 2022

#### Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur misionin e INSTAT-it për prodhimin e statistikave asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit;

Duke marrë në konsideratë se INSTAT-i është prodhuesi kryesor i statistikave zyrtare në vend dhe përgjegjës për koordinimin dhe funksionimin e Sistemit Kombëtar Statistikor;

Duke vlerësuar se statistikatat zyrtare shpërndahen duke respektuar parimet statistikore të përcaktuara në ligj, duke mbrojtur konfidencialitetin statistikor dhe duke siguruar akses të barabartë për të gjithë përdoruesit;

Duke inkurajuar forcimin e bashkëpunimit të INSTAT-it me prodhuesit dhe përdoruesit e statistikave zyrtare brenda dhe jashtë vendit për të



plotësuar nevojat e tyre me informacion cilësor e të përditësuar dhe për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera në rajon dhe Evropë;

**Vlerëson veprimtarinë e Institutit të Statistikave gjatë vitit 2022 në drejtim të:**

Rritjes së konsiderueshme të numrit të statistikave të prodhuara dhe transmetuara në Eurostat dhe të vlerësuara si statistika cilësore të prodhuara sipas standardeve profesionale.

Paraqitjes relativisht të lartë në medie, duke e rritur imazhin e institucionit, por edhe duke sjellë në vëmendje nevojën e përdoruesve për statistika, si: të hartuesve të politikave, studiuesve, bizneseve, medieve etj.

Angazhimit të tij në paraqitjen e raporteve, mendimeve e studimeve në arenën ndërkombëtare në fushën e prodhimit dhe zhvillimit statistikor, duke marrë pjesë dhe kontribuar në forume dhe aktivitete të ndryshme botërore të statistikave.

Rritjes së numrit të indikatorëve statistikorë në kuadër të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023 në kuadër të përputhshmërisë së plotë me legjislacionin evropian.

**Kuvendi rekomandon që Instituti i Statistikave për vitin 2023 të përmirësojë punën në këto drejtime:**

1. Të zbatojë me cilësi dhe në kohë Censin e Popullsisë dhe Banesave, duke u bazuar në përcaktimin e qartë të vizionit dhe objektivave strategjike për kryerjen e censit, si dhe duke e konsideruar atë instrument kryesor për procesin e negociatave.

2. Të kushtojë vëmendje të veçantë zbatimit dhe monitorimit të strategjisë së komunikimit për promovimin e Censit të Popullsisë dhe Banesave, i cili është thelbësor për të siguruar ndërgjegjësimin statistikor, rritjen e besueshmërisë dhe pjesëmarrjen e popullatës në këtë proces.

3. Të finalizojë dokumentet strategjike të Censit të Bujqësisë, të cilat do të shërbejnë për të planifikuar elementet më të rëndësishme të projektit, duke filluar me përgatitjen e kuadrit rregullator, vlerësimin e burimeve dhe aktorëve që do të përfshihen, buxhetin, si dhe përcaktimin e metodologjisë që do të ndiqet për Censin e Bujqësisë 2024. Të paraqitet sa më parë në

Kuvend për miratim projektligji për Censin e Bujqësisë.

4. Të vazhdojë modernizimin e metodave të mbledhjes së të dhënave dhe prodhimit statistikor të Sistemit Kombëtar Statistikor, si mekanizimi kryesor për prodhimin e statistikave në përputhje me standardet e kërkuara nga Eurostat dhe në përputhje me teknikat me moderne ndërkombëtare.

5. Të vijojë përpjekjet për zgjerimin e Sistemit Kombëtar Statistikor me shtimin e institucioneve prodhuese dhe furnizuese me të dhëna, rritjen e gamës së produkteve statistikore zyrtare të prodhuara dhe rritjen e cilësisë statistikore.

6. Të bëjë përpjekje për uljen e qarkullimit të punonjësve dhe të sigurojë që niveli i plotësimit me punonjës është i mjaftueshëm për përmbushjen e nevojave të prodhimit statistikor. Gjithashtu, punonjësit të jenë të mirëtrajnuar lidhur me zhvillimet e fundit në fushën e statistikave.

7. Të rrisë prodhimin dhe transmetimin e të dhënave makroekonomike në kohë dhe me cilësi të lartë në Eurostat për të arritur përputhje të plotë me standardet e ESA 2010 dhe të punojë për shtimin e treguesve të rëndësishëm, të cilët ende nuk i transmetohen Eurostatit.

8. Të intensifikojë bashkëpunimin statistikor kombëtar dhe ndërkombëtar për të përshtatur metodologjitë dhe praktikat më të mira në rritjen e rolit të tij në qeverisjen e të dhënave publike si pjesë e ekosistemit të të dhënave, që shërbejnë për prodhimin e statistikave zyrtare, pa cenuar besimin në statistika dhe konfidencialitetin.

KRYETARE  
Lindita Nikolla

Miratuar më datë 13.7.2023.

**REZOLUTË**

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË  
ENTIT RREGULLATOR  
TË ENERGJISË PËR VITIN 2022**

**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur Entin Rregullator të Energjisë si rregullatori i vetëm dhe i pavarur për mbikëqyrjen e funksionimit të tregut të energjisë elektrike e të gazit natyror, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit





ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke vlerësuar trendin pozitiv të uljes së nivelit të humbjeve të energjisë elektrike në sistemin e shpërndarjes, i cili vijon të ketë një rënie nga viti në vit, humbjet e energjisë elektrike për vitin 2022 arritën në nivelin 19.7%, duke shënuar një ulje të mëtejshme krahasuar me vitin 2021, ndërkohë niveli total i arkëtimeve për vitin 2022 arriti shifrat 98% duke shënuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2021;

Duke theksuar se situata e krizës globale energjetike dhe luftës në Ukrainë ka çuar në një rritje të çmimit të energjisë në tregun ndërkombëtar në nivele tepër të larta, me pasojat të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit;

Duke vlerësuar si arritje të rëndësishme bërjen operacionale dhe fillimin nga puna të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a.;

#### **Vlerëson për vitin 2022:**

Kontributin e ERE-s, bashkëpunimin me Ministrinë e Infrastrukturës, rregullatorin e Kosovës, si dhe aktorët e tjerë në bërjen operacionale dhe fillimin nga puna të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., e cila krijon mundësinë për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike që në mënyrë transparente të konkurrojnë me njëri-tjetrin duke përfutur nga bursa, por nga ana tjetër duke i dhënë kështu edhe industrisë së vendit dhe tregut mundësinë për të marrë energji elektrike me çmime sa më të konkurrueshme dhe sa më të ulëta;

Punën e bërë nga ERE-ja dhe bashkëpunimin me të gjithë aktorët në përgatitjen e projektligjit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, i cili përmirëson kuadrin ligjor bazë të energjisë së rinovueshme në Shqipëri, duke u orientuar tek burimet e sigurt, të pashtershme, miqësore me mjedisin e me eficiencë të lartë, si dhe duke ndikuar drejtpërdrejt në uljen e konsumit të energjisë nga rrjeti dhe diversifikimin e prodhimit të energjisë;

Punën e bërë nga ERE-ja lidhur me miratimin e disa akteve nënligjore, të cilat kanë ndikim si për mundësinë e ndërtimit të rrjetit të transmetimit dhe atë të shpërndarjes së gazit, si dhe miratimin e akteve nënligjore për Terminalin e LNG-së (Gazit Metan të Lëngëzuar) dhe aktet e tjera për ruajtjen nëntokësore të gazit natyror;

Punën e bërë nga ERE-ja lidhur me vendosjen e linkut/grafikës “Bëj një ankesë” dhe numrit të gjelbër në dispozicion të qytetarëve/ konsumatorëve në faqen zyrtare kryesore të ERE-s në internet, përgatitjen e broshurave (materialeve) informuese/sensibilizuese për konsumatorin, si dhe publikimin e tyre në faqen zyrtare të ERE-s dhe në rrjete sociale për të informuar konsumatorin në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe me një sërë aspektesh të rregullimit, që afektojnë interesat e tyre si konsumatorë;

Punën e bërë nga ERE-ja lidhur me miratimin dhe zbatimin e Rregullores për Masat e të Licencuarve në Aktivitetin e Furnizimit për Arritjen e Treguesve të Matjes dhe Vlerësimit si një hap i rëndësishëm që ndikon në ofrimin e një shërbimi cilësor dhe me standarde për konsumatorin.

#### **Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2023 i rekomandon ERE-s:**

1. Të luajë një rol proaktiv dhe të bashkëpunojë me të gjithë aktorët për të bërë të mundur lehtësimin e barrierave dhe nxitjen e investimeve në rritjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme (dielli, era dhe forma të tjera), shfrytëzimi i burimeve diellore dhe të erës do të përmirësonte ndjeshëm sigurinë energjetike të vendit duke diversifikuar burimet e energjisë dhe duke e bërë sistemin më pak të ekspozuar ndaj ndikimeve klimatike;

2. Të angazhohet në miratimin në një kohë sa më të shkurtër të akteve rregullatore që dalin si detyrim pas miratimit në Kuvend të ligjit “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”;

3. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të bashkëpunojë me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe aktorët e tjerë në draftimin e rregullores për kriteret specifike dhe procedurat për përfitim të statusit të klientëve në nevojë të parashikuara në legjislacionin në fuqi;

4. Të marrë masa që numri i gjelbër të jetë funksional dhe të ketë stafin përkatës, i cili bën të mundur adresimin në kohë reale të kërkesave për informacion të konsumatorit, si dhe jep orientimet për adresimin më të shpejtë të ankesave sipas legjislacionit në fuqi. Në të njëjtën kohë, duke pasur parasysh fuqinë e medieve sociale, të jetë më aktive në promovimin përmes tyre të të drejtave të konsumatorëve, sensibilizimin e tyre mbi kursimin e energjisë elektrike, broshurave informative për



konsumatorin, si dhe informacione të tjera që i shërbejnë konsumatorit;

5. Të rrisë përpjekjet për implementimin brenda vitit 2023 të platformës së krahasimit të çmimeve (*Price Comparison Tool*), e cila u ofron furnizuesve mundësinë e paraqitjes së çmimeve të energjisë elektrike për konsumatorët që zgjedhin të furnizohen nga tregu i lirë duke i dhënë mundësinë e vlerësimit në mënyrë transparente të ofertave;

6. Të vijojë kontributin e saj për bashkërendimin e punës mes rregullatorëve, TSO-ve dhe bursës për të mundësuar bashkimin e tregjeve jo vetëm ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe më tej me Maqedoninë e Veriut apo Malin e Zi;

7. Të vijojë bashkëpunimin me “Albgas” sh.a. lidhur me tubacionin nga Terminali në Vlorë deri në pikën e takimit me TAP në Fier, e cila, nga njëra anë, krijon mundësinë e përsheptimit të riparimit të TEC-it Vlorë dhe të vendosjes së tij në punë dhe, nga ana tjetër, krijon mundësinë që të injektohet gaz edhe në rrjetin e TAP-it për nevojat e rajonit;

8. Në bashkëpunim me aktorët e tjerë të fushës, të ndërmarrë veprime koherente dhe me objektiva të qartë për të krijuar një treg funksional gazi, që shfrytëzon potencialin e infrastrukturës ekzistuese në vend dhe krijon bazat e tregut për planet e zhvillimit të infrastrukturës;

9. Të vijojë bashkëpunimin me Agjencinë e Eficiencës për hartimin e një strategjie të përbashkët afatmesme për adresimin e çështjeve me interes të konsumatorit sa i përket përdorimit eficient të energjisë;

10. Gjatë vitit 2023 të punojë për implementimin e sistemit të lëshimit, anulimit dhe tregtimit të garancive të origjinës në përputhje me standardet e BE-së.

KRYETARE  
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 13.7.2023.

## REZOLUTË

### **PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE PËR VITIN 2022**

#### **Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke besuar në objektivat dhe përpjekjet e vendit tonë për intensifikimin e luftës kundër korrupsionit, si kusht dhe detyrim thelbësor në kuadër të procesit të integritetit dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

Duke theksuar rëndësinë e koordinimit dhe forcimit të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përgjegjëse ligjzbatuese në vend dhe institucioneve të pavarura për rritjen e efikasitetit të hetimeve penale apo administrative, si dhe ndëshkimin e praktikave korruptive, me qëllim arritjen e rezultateve konkrete dhe të prekshme në parandalimin dhe luftën ndaj korrupsionit;

Duke vlerësuar gjetjet në raportin për Shqipërinë për vitin 2022 të Komisionit Evropian në lidhje me progresin e shënuar nga Inspektorati, si dhe mbështetjen e vazhdueshme nga partnerët ndërkombëtarë për përmbushjen e objektivave prioritarë të institucionit;

Duke inkurajuar e mbështetur Inspektoratin me forcimin e kapaciteteve administrative, teknike, financiare dhe të instrumenteve ligjore, me qëllim përmbushjen e misionit institucional për zbulimin e pasurimit korruptiv dhe praktikave të ngjashme me të në parandalimin e konfliktit të interesave për të gjitha kategoritë e zyrtarëve, subjekteve të ligjit dhe personave të lidhur, si dhe inkurajimin për denoncimin e tyre;

**Vlerëson veprimtarinë e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2022, në drejtim të:**

Progresit të shënuar në funksionimin tërësor institucional dhe, në veçanti, në përmbushjen e të gjitha rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2021”;

Angazhimit në përputhje me rekomandimet e progresraportit të KE-së për përfundimin dhe



vënien në funksionalitet të plotë të sistemit elektronik të interesave privatë, si dhe organizimin e disa sesioneve trajnuese për 310 autoritete përgjegjëse, duke adresuar kështu të gjitha kërkesat për asistencë të paraqitura nga subjektet deklaruese dhe përmbyllur procesin e deklarimit brenda datës 31 tetor 2022;

Përmbylljen në mënyrë të efektshme të rekomandimeve të lëna në raportin e vlerësimit të Grupit të Shteteve Kundër Korrupsionit të Këshillit të Evropës (GRECO) në raundin V, ku në raportin e parë të përputhshmërisë, Inspektorati i Lartë u vlerësua si institucioni që plotësoi në mënyrë të kënaqshme ose plotësisht të tria rekomandimet, të cilat kishin të bënin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë me punën dhe veprimtarinë e tij;

Intensifikimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndaj luftës kundër korrupsionit, me qëllim shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve, siç janë edhe nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit të ndërsjella institucionale me SPAK-un në datën 30 mars 2022 dhe me ministrin e Drejtësisë në datën 6 qershor 2022;

Zbulimit të rasteve të fshehjeve të pasurisë, si dhe shkeljeve të ndryshme të ligjit për deklarimin e interesave privatë, duke administruar një numër total prej 3975 deklaratash e interesave privatë, duke kaluar në kontroll të plotë për verifikimin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që përmbahen në deklaratën e pasurisë dhe të interesave privatë 806 subjekte deklarues, duke ndëshkuar me masën administrative “gjobë” për rastet e refuzimeve për deklarim, rastet e mosdeklarimeve dhe rastet e konfliktit të interesit 128 zyrtarë, si dhe duke paraqitur pranë prokurorisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, Policisë së Shtetit dhe strukturave të hetimit tatimor 37 raste referimesh penale;

Mbështetjes së procesit reformues të sistemit të drejtësisë, me fokus të veçantë forcimin e bashkëpunimit me organet e rivlerësimit dhe ONM-në nëpërmjet trajtimit me përparësi të 63 kërkesave të ardhura nga këto institucione, si dhe në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në ligjin për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe ligjit për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme nga Inspektorati është

ushtruar kontroll i plotë për 264 kandidatë në organet e ndryshme të sistemit të drejtësisë;

Administrimit dhe analizimit të 439 raportimeve të dërguara nga njësitë përgjegjëse të ngritura në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, nga të cilat 178 i përkasin sektorit publik dhe 261 sektorit privat, si dhe përditësimit të të dhënave të regjistrave kombëtarë të këtyre njësive;

Monitorimit të kujdesshëm dhe të vazhdueshëm të zbatimit të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, në bashkëpunim intensiv me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Departamentin e Administratës Publike dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;

Regjistrimit dhe trajtimit në zbatim të kompetencave ligjore, si mekanizëm i jashtëm raportimi për sinjalizimin dhe kërkesat për mbrojtje nga hakmarrja të 13 rasteve sinjalizimi dhe 2 kërkesa për mbrojtje nga hakmarrja;

Nxjitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar, ku krahas vijimit të marrëdhënieve të ngushta dhe të frytshme me Delegacionin e Bashkimit Evropian, Këshillin e Evropës, Zyrën e OSBE-së, Agjencitë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si USAID, u intensifikua komunikimi me zyrat homologe apo agjencitë antikorrupsion në rajon dhe më gjerë, ku vlen për të theksuar nënshkrimi i marrëveshjes së mirëkuptimit në shtator të vitit të shkuar me Agjencinë Kombëtare të Integritetit të Rumanisë;

Angazhimit të mëtijshëm për përmirësimin e kanaleve të raportimit të sinjalizimeve dhe mekanizmat e mbrojtjes për sinjalizuesit nëpërmjet përmbylljes së angazhimeve të marra në marrëveshjen e bashkëpunimit me Iniciativën Rajonale Antikorrupsion (RAI) të financuar nga BE-ja;

Ndjekjes së një politike të hapur me qytetarët e shoqërinë civile, si dhe forcimin e bashkëpunimit me medien investigative në veçanti, duke trajtuar me përparësi, korrektësi dhe brenda afateve ligjore kërkesat e publikut në lidhje me publikimin e deklaratave të interesave privatë.

**Kuvendi kërkon që Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2023 të vazhdojë punën në këto drejtime:**

Të garantojë funksionalitetin e plotë të Sistemit Elektronik të Deklarimit të Interesave Privatë, që



kontribuon drejtpërsëdrejti në forcimin e besueshmërisë të institucionit, duke u angazhuar në rritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të autoriteteve përgjegjëse dhe në marrjen e masave të nevojshme ligjore dhe administrative për garantimin e qëndrueshmërisë dhe sigurisë së informacionit;

Të forcojë bashkëpunimin me institucionet vendëse dhe ndërkombëtare për të përmbushur të gjitha rekomandimet, të cilat do të hartohen në përfundim të takimeve dypalëshe për harmonizimin e legjislacionit të brendshëm me *acquis communautaire*, me fokus proceset e integritetit evropian;

Të intensifikojë bashkëpunimin ndërinstitucional në kuadër të luftës kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik, si një element i domosdoshëm në drejtim të garantimit të sigurisë dhe efektivitetit të kontrolleve dhe hetimeve administrative;

Të intensifikojë trajnimet e stafit në drejtim të forcimit të kapaciteteve administrative dhe investiguese për të qenë kështu garant i paanshmërisë, transparencës dhe objektivitetit të institucionit;

Të angazhohet më tepër për të siguruar efektivitet në zbatimin e ligjit për sinjalizuesit, me qëllim inkurajimin e raportimit të praktikave korruptive si nga njësitë e sektorit publik, ashtu edhe nga njësitë e sektorit privat përmes trajnimit të rregullt dhe informimit të stafit të këtyre njësive, me fokus të veçantë strukturat e Policisë së Shtetit në përputhje me rekomandimet e lëna nga GRECO.

KRYETARE  
Lindita Nikolla

Miraturar më datë 13.7.2023.

**VENDIM**  
**Nr. 424, datë 19.7.2023**

**PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Meri Kumbi, zëvendësministër i Kulturës, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

**VENDIM**  
**Nr. 425, datë 19.7.2023**

**PËR EMËRIMIN E DY ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Znj. Elira Kokona emërohet anëtar i këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Kryeministrit.

2. Z. Ermal Nufi emërohet anëtar i këshillit drejtues të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, përfaqësues i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

**VENDIM**  
**Nr. 427, datë 19.7.2023**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 KV FIBËR, LIBRAZHD”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në



përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i linjës 110 kV fibër, Librazhd”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “arë” dhe “ullishte”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 275 925 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 275 925 (një milion e dyqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzet e pesë) lekësh, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

8. Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë së pasurive që shpronësohen, sipas këtij vendimi, në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për Operatorin e Sistemit të Transmetimit sh.a.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Zyra Vendore Librazhd, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**



LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIMI I LINJËS 110 kV FIBËR-LIBRAZHËD”

| NR. Rendor | NR. Shrylle | PRONARI                                                                                                                     |                                                                       |                                                                                                              | TË DHËNA KADASTRALE |               |                |                  |                   |            |               |                 |        | VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM |                 |                 |              |                 |                 | Seksionet D & E te kartelës se pasurisë | ADRESA:   | SHËNIME:                                                                                          |                                                    |                        |
|------------|-------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------|---------------|----------------|------------------|-------------------|------------|---------------|-----------------|--------|---------------------------|-----------------|-----------------|--------------|-----------------|-----------------|-----------------------------------------|-----------|---------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------|------------------------|
| 17           | Bp-2 | Avdi Nika                                                                                                                                                     | 3140                 | 149/3          | 5000                              | pemëtore       | 1359.1096                   | 11,576.03         | 15,733,093.50                | 15,733,093.50  | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 18           | Bp-2 | Karafil Mjalti                                                                                                                                                | 3140                 | 149/9          | 2670                              | pemëtore       | 12.16                       | 11,576.03         | 140,764.52                   | 140,764.52     | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 19           | Bp-2 | Artjan Shehaj                                                                                                                                                 | 3140                 | 160/8/2        | 1000                              | arë            | 429.8                       | 11,576.03         | 4,975,377.69                 | 4,975,377.69   | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 20           | Bp-2 | Alim Rokaj<br>Dritan Banush Serjanaj                                                                                                                          | 3140                 | 160/9          | 2600                              | arë            | 580.7                       | 11,576.03         | 6,722,200.62                 | 6,722,200.62   | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 21           | Bp-2 | Murat Hasanaj                                                                                                                                                 | 3140                 | 211/3          | 5100                              | pemëtore       | 1596                        | 11,576.03         | 18,475,343.88                | 18,475,343.88  | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 22           | Bp-2 | Mjaftime Halil Xhelilaj                                                                                                                                       | 3140                 | 2/1/1          | 1180                              | pemëtore       | 279.3                       | 11,576.03         | 3,233,185.18                 | 3,233,185.18   | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 23           | Bp-2 | Rabie Halil Lika<br>Adeline Habil Jazoj                                                                                                                       | 3140                 | 2/1/3          | 2100                              | pemëtore       | 696.8                       | 11,576.03         | 8,066,177.70                 | 8,066,177.70   | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 24           | Bp-2 | Fitim Tefa<br>Sazan Laze Tefa Leonard<br>Tefa<br>Pellumb Tefa                                                                                                 | 3140                 | 505/1          | 5000                              | arë            | 304.88                      | 11,576.03         | 3,529,300.03                 | 3,529,300.03   | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| 25           | Bp-2 | Artan Servet Danaj,<br>Petro Sokrat Dani, Arjan<br>Sevet Danaj, Astrit<br>Servet Dani, Shpetim<br>Servet Xhaferaj,<br>Edi Pajtim Dani,<br>Sonila Pajtim Danaj | 3140                 | 211/9          | 60                                | pemëtore       | 3.2                         | 11,576.03         | 37,043.30                    | 37,043.30      | Vlorë   | Radhimë | Konfirmuar nga ASHK-ja |
| Vlera totale |      |                                                                                                                                                               |                      |                |                                   |                |                             |                   | 202,682,342.35               | 202,682,342.35 |         |         |                        |

**VENDIM****Nr. 429, datë 19.7.2023****PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË  
DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT  
KUKËS**

Në mbështetje të neneve 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 5, të ligjit nr. 107/2016, “Për prefektin e qarkut”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Z. Ali Hallaçi, prefekt i Qarkut Kukës, lirohet nga kjo detyrë.

2. Z. Albert Halilaj emërohet prefekt i Qarkut Kukës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 431, datë 19.7.2023****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN  
NR. 1497, DATË 19.11.2008, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR SHTYPJEN E  
LETRAVE ME VLERË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në pikën 2, të vendimit nr. 1497, datë 19.11.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen e letrave me vlerë”, të ndryshuar, pas fjalëve “...biletat e transportit rrugor dhe atij hekurudhor...” shtohen “...kuponët për dokumente biometrike...”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 432, datë 19.7.2023****PËR TRANSFERIMIN E PRONËSISË SË  
67.21% TË AKSIONEVE TË SHOQËRISË  
“TREGU I SHITJES ME SHUMICË  
FRUTA-PERIME” SHA, SHKODËR, NGA  
MINISTRIA E FINANCave DHE  
EKONOMISË TEK BASHKIA SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të tretë, të nenit 4, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Transferimin e pronësisë së 67.21% të aksioneve të shoqërisë “Tregu i shitjes me shumicë fruta-perime” sh.a., Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Shkodër, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR  
Edi Rama**



## VENDIM

Nr. 433, datë 19.7.2023

**PËR TRANSFERIMIN NË FONDIN E  
PASURIVE TË PALUAJTSHME PËR  
MBËSHTETJEN E INVESTIMEVE  
STRATEGJIKE PËR VËNIEN NË  
DISPOZICION TË INVESTITORIT  
STRATEGJIK TË PRONËS SË  
PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË  
ZONËN KADASTRALE NR. 8561,  
BASHKIA KORÇË, PËR ZHVILLIMIN  
DHE REALIZIMIN E PROJEKTIT  
INVESTUES STRATEGJIK “*GREEN  
HOUSE KORÇA RESORT*”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, të nenit 27, të ligjit nr. 55/2015, “Për investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 3, të kreut II, të vendimit nr. 1030, datë 16.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin dhe formën e pjesëmarrjes së shtetit në investimet strategjike dhe rregullat për krijimin, funksionimin e administrimin e fondit të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e investimeve strategjike”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Transferimin në Fondin e Pasurive të Paluajtshme për Mbështetjen e Investimeve Strategjike (FPPMIS) të pronës së paluajtshme shtetërore, në zonën kadastrale nr. 8561, me numër pasurie 1/911, të llojit “truall”, me sipërfaqe të përgjithshme 10 000 (dhjetë mijë) m<sup>2</sup>, në pronësi “shtet”, me vendndodhje Bashkia Korçë, sipas kartelës së pasurisë dhe fragmentit të hartës kadastrale që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Prona e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, vihet në dispozicion për zhvillimin dhe realizimin e projektit investues strategjik “*Green House Korça Resort*”, me subjekt investues “*Investment and Development Albania*” sh.p.k., me NUIS L91703053C.

3. E drejta e përdorimit të pronës së përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, nga investitori strategjik “*Investment and Development Albania*” sh.p.k., me NUIS L91703053C, detyrimet dhe kushtet e përdorimit bazohen në pikën 7, shkronja “c”, dhe 11, të vendimit nr. 29/4, datë 1.2.2023, të Komitetit të Investimeve Strategjike.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8561055019  
(Nga 8561054159, Në \_\_\_\_)

**A - TË DHËNAT E PASURISË**

Zona Kadastrale Nr. 8561, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 1/911, Sipërfaqja Totale 10000 m<sup>2</sup>,  
(Nga të Cilat Truall 10000 m<sup>2</sup>; Ndërtesë 0 m<sup>2</sup>)

Indeksi i Hartës Kadastrale KO-I-9, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia KORÇË, Rruga \_\_\_\_\_, Ndërtesa Nr. \_\_\_\_\_, SH/K \_\_\_\_\_, Apartamenti Nr. \_\_\_\_\_

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. 301, Dt. 19/05/2021), Rivlerësim \_\_\_\_\_ (Akti Nr. \_\_\_\_\_, Dt. \_\_\_\_\_)

**B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË**

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, Nr. Identifikimi/NIPT SG463975699, Pjesa Takuese 1/1,  
Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia \_\_\_\_\_, Rruga \_\_\_\_\_, Ndërtesa Nr. \_\_\_\_\_, SH/K \_\_\_\_\_, Apartamenti Nr. \_\_\_\_\_

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. 301, Datë: 19/05/2021

Regjistruar: Nr. 00024653, Datë: 22/06/2021

*\*Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. \_\_\_\_\_, me Kod Unik \_\_\_\_\_*

**B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK**

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: \_\_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_

Përshkrimi i Objektit të Aktit: \_\_\_\_\_

Regjistruar: Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS**

**KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME**

**C-TË DREJTAT REALE**

| Nr. Regjistrimi | Dt. Regjistrimi | Lloji i të Drejtës | Të Dhënat e Aktit                             |     |            | Afati i Vlefshmërisë | Përfitues                         |                       |
|-----------------|-----------------|--------------------|-----------------------------------------------|-----|------------|----------------------|-----------------------------------|-----------------------|
|                 |                 |                    | Emërtim                                       | Nr. | Datë       |                      | Emër Atësi Mbiemër                | Nr. Identifikimi/NIPT |
| 00024653        | 22/06/2021      | Administrim        | VKM për të drejtën e administrimit/përdorimit | 301 | 19/05/2021 | 999 vite             | MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT | SG656439884           |

**D - KUFIZIMET E PRONËSISË**

| Nr. Regjistrimi | Dt. Regjistrimi | Lloji i Kufizimit | Të Dhënat e Aktit |     |      | Afati i Kufizimit | Përfitues/Kërkues  |                       |
|-----------------|-----------------|-------------------|-------------------|-----|------|-------------------|--------------------|-----------------------|
|                 |                 |                   | Emërtim           | Nr. | Datë |                   | Emër Atësi Mbiemër | Nr. Identifikimi/NIPT |
|                 |                 |                   |                   |     |      |                   |                    |                       |

**E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN**

Lloji i Informacionit: \_\_\_\_\_, Emërtimi i Aktit: \_\_\_\_\_, Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_

Regjistruar: Nr. \_\_\_\_\_, Datë: \_\_\_\_\_

Përshkrimi:

**DREJTORI**  
**Johand Sulo**

Johand  
Sulo

Digitally signed by:  
Johand Sulo  
Date: 2023.07.07  
11:59:29 +02'00'

**Data e lëshimit 03/07/2023**



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Korpë  
Date: 2023/07/03 15:35:19 +02'00'  
K51716026T2023070315351260ASHK

*Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vuloar me anë të një procedurë automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)*

2/2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS  
**FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE**

ZONA KADASTRALE: 8561 KODI UNIK: 8561055019  
NUMRI I PASURISË: 1/911 INDEX I HARTËS: KO-2-9  
KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

SH 1: 8000

Shënim : Ky dokument Shtetëror dhe Vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtorja Vendore Korçë)

Vulosur elektronikisht nga Drejtorja  
Vendore Korçë  
Date: 2023/07/07 12:02:08 +02'00'  
K51716026T2023070712020105014

Digitally signed by  
Johand Sulo  
Date: 2023.07.07

SHPJEGUES  
PARCELA  
NDERTESA



**VENDIM****Nr. 434, datë 19.7.2023**

**PËR MIRATIMIN E KOEFICIENTIT TË  
INDEKSIMIT TË BAZËS SË  
VLERËSUAR TË VITIT 2021 PËR  
LLOGARITJEN E PENSIONEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit 2021, me indeksin 8.9% të llogaritur sipas kriterëve të përcaktuar në nenin 59, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Indeksi i përcaktuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, aplikohet për rivlerësimin e bazës së vlerësuar të arritur nëpërmjet kontributeve të derdhura dhe rivlerësimeve të tyre, të kryera deri në vitin 2021, dhe zbatohet për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensioneve që do të caktohet me datë fillimi nga data 1 korrik 2023 e në vazhdim.

3. Indekset akumulative të bazës së vlerësuar, të arritur nëpërmjet pagave të periudhës 1994–2021, referuar kontributeve të derdhura sipas muajve në këtë periudhë dhe pagave referuese sipas punëve dhe profesioneve, e përcaktuar me vendimin nr.

561, datë 12.8.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, të ndryshuar, sipas viteve, janë sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Pas aplikimit të indeksit të vitit 2021, baza e vlerësuar për efekt të llogaritjes së shumës fillestare mujore të pensioneve, që do të caktohen me datë fillimi nga data 1 korrik 2023, nuk mund të jetë më e lartë se:

a) trefishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 40 000 lekësh, e përcaktuar sipas vendimit nr. 113, datë 1.3.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, për pagat e periudhës nga viti 1994 deri në 31.12.2001;

b) paga maksimale në shkallë vendi, prej 176 416 lekësh, e përcaktuar sipas kriterëve të paragrafit të fundit, të nenit 10, të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për pagat nga viti 2002 e në vazhdim.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për zbatimin e formulës së caktimit të pensioneve, aplikohen vetëm për pensionet që caktohen me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim dhe përballohen brenda buxhetit vjetor të miratuar për Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2023.

**KRYEMINISTËR****Edi Rama****SHTOJCA I**

| <b>Tabela e koeficienteve akumulative të indeksimit të bazës së vlerësuar</b> |        |
|-------------------------------------------------------------------------------|--------|
| Për pagat referuese deri më datë 31.12.1993                                   | 10.799 |
| Për pagat e vitit 1994                                                        | 10.799 |
| Për pagat e vitit 1995                                                        | 8.691  |
| Për pagat e vitit 1996                                                        | 6.743  |
| Për pagat e vitit 1997                                                        | 6.743  |
| Për pagat e vitit 1998                                                        | 5.634  |
| Për pagat e vitit 1999                                                        | 4.573  |
| Për pagat e vitit 2000                                                        | 4.165  |
| Për pagat e vitit 2001                                                        | 3.563  |
| Për pagat e vitit 2002                                                        | 3.291  |





|                        |       |
|------------------------|-------|
| Për pagat e vitit 2003 | 2.945 |
| Për pagat e vitit 2004 | 2.676 |
| Për pagat e vitit 2005 | 2.430 |
| Për pagat e vitit 2006 | 2.206 |
| Për pagat e vitit 2007 | 2.108 |
| Për pagat e vitit 2008 | 1.862 |
| Për pagat e vitit 2009 | 1.713 |
| Për pagat e vitit 2010 | 1.640 |
| Për pagat e vitit 2011 | 1.578 |
| Për pagat e vitit 2012 | 1.518 |
| Për pagat e vitit 2013 | 1.455 |
| Për pagat e vitit 2014 | 1.455 |
| Për pagat e vitit 2015 | 1.257 |
| Për pagat e vitit 2016 | 1.257 |
| Për pagat e vitit 2017 | 1.233 |
| Për pagat e vitit 2018 | 1.189 |
| Për pagat e vitit 2019 | 1.161 |
| Për pagat e vitit 2020 | 1.129 |
| Për pagat e vitit 2021 | 1.089 |
| Për pagat e vitit 2022 | 1.000 |
| Për pagat e vitit 2023 | 1.000 |

**VENDIM****Nr. 437, datë 19.7.2023**

**PËR SHITESË FONDI NË BUXHETIN E  
MIRATUAR PËR VITIN 2023, PËR DISA  
INSTITUCIONE TË PAVARURA, TË  
KRIJUARA ME LIGJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “a”, të pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Prokurorisë së Përgjithshme shtohet fondi prej 400 000 000 (katërqind milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

2. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë shtohet fondi prej 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

3. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor shtohet fondi prej 300 000 000 (treqind milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023 – 31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

4. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Gjykatës Kushtetuese shtohet fondi prej 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

5. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar shtohet fondi prej 55 000 000 (pesëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga



data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

6. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë shtohet fondi prej 6 000 000 (gjashtë milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

7. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

8. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit shtohet fondi prej 15 600 000 (pesëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

9. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Komisionerëve Publikë shtohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

10. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve shtohet fondi prej 5 500 000 (pesë milionë e pesëqind mijë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”.

11. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Avokatit të Popullit shtohet fondi prej 2 000 000 (dy milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

12. Në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Shkollës së Magjistraturës shtohet

fondi prej 40 000 000 (dyzet milionë) lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023–31 dhjetor 2023, të përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor 606 “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”.

13. Fondi shtesë, prej 892 600 000 (tetëqind e nëntëdhjetë e dy milionë e gjashtëqind mijë) lekësh, përballohet nga fondi kontingjencës, i miratuar në buxhetin e vitit 2023.

14. Ngarkohen institucionet e përmendura më sipër për detajimin e fondit përkatës dhe dërgimin e tij pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTËR  
Edi Rama

**VENDIM**  
**Nr. 438, datë 19.7.2023**

**PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE,  
PROCEDURAVE DHE KRITEREVE PËR  
TRAJTIMIN E PUNONJËSVE TË  
NJËSISË SË POSAÇME HETIMORE  
KUNDËR KORRUPSIONIT DHE  
KRIMIT TË ORGANIZUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 40/1, të ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I  
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1  
Objekti

1. Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave, procedurave dhe kriterëve për trajtimin e drejtorit, zëvendës drejtorit, hetuesit dhe oficerit të shërbimit të Policisë Gjyqësore të Njesisë së Posaçme Hetimore kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e emërtuar si Byroja Kombëtare e Hetimit, këtu e në vijim “punonjësit”.



2. Trajtimi i punonjësit përfshin të drejtën e pushimit vjetor dhe pushimeve të tjera të pagueshme, lejen pa të drejtë page, trajtimin financiar gjatë qëndrimit në punë, të drejtën për sigurim shëndetësor të veçantë, të drejtën për përfitim të kredisë me interesa të butë, sigurimin e jetës, mbrojtjen e veçantë, si dhe trajtimin e familjarëve të punonjësve që humbasin jetën për shkak të detyrës.

#### Neni 2 Qëllimi

Ky vendim ka si qëllim garantimin e një trajtimi që i përshtatet natyrës së punës dhe përgjegjësi gjatë ushtrimit të detyrës së punonjësit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, si dhe garantimin e efikasitetit e të pavarësisë nga çdo ndikim i paligjshëm, i brendshëm apo i jashtëm.

### KREU II KOHHA E PUSHIMIT TË PUNONJËSVE

#### Neni 3 Pushimet vjetore

1. Punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit gëzon të drejtën e pushimit vjetor, si dhe të pushimeve të tjera të pagueshme, me të njëjtin trajtim që përfitojnë punonjësit e Policisë së Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi për Policinë e Shtetit.

2. Punonjësi gëzon të drejtën e pushimeve vjetore të paguara, si më poshtë vijon:

a) 40 (dyzet) ditë kalendarike për drejtorin dhe zëvendësdrejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit;  
b) 35 (tridhjetë e pesë) ditë kalendarike për hetuesin e Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerin e shërbimit të Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

3. Leja vjetore mund të merret njëherësh ose në periudha të ndryshme, sipas kërkesës së punonjësit dhe në përputhje me kërkesat e funksionit. Leja vjetore duhet të përfshijë një periudhë trejavore pa ndërprerje gjatë muajit gusht, përveç kur kërkesat e ushtrimit të funksionit kërkojnë vazhdimin e aktiviteteve të strukturës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Kur, për shkak të detyrës, pushimi vjetor nuk mund të jepet brenda vitit, ai duhet të jepet jo më vonë se muaji mars i vitit pasardhës. Në çdo rast, leja vjetore nuk

duhet të jetë më pak se një javë kalendarike pa ndërprerje.

4. Leja vjetore miratohet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, pas konsultimit me punonjës, pa cenuar vijueshmërinë e punës dhe pas marrjes së mendimit të prokurorit të posaçëm pranë të cilit është caktuar punonjësi.

5. Gjatë kryerjes së pushimeve vjetore punonjësi trajtohet financiarisht në të njëjtën masë me pagën që ai merr kur është në detyrë.

6. Kur punonjësi i ndërpriten marrëdhëniet e punës, trajtohet menjëherë financiarisht për ditët e pushimit vjetor të pakryera, të llogaritura në raport me kohëzgjatjen e tij të punës brenda vitit kalendarik.

7. Kur punonjësi nuk ka kryer një vit të plotë kalendarik pune, kohëzgjatja e pushimit vjetor të paguar përcaktohet në përpjesëtim të drejtë me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës së kryer brenda vitit kalendarik. Pushimi vjetor përfitohet vetëm pasi punonjësi ka ushtruar detyrën për një periudhë 3-mujore (tremujore).

8. E drejta e pushimeve që nuk jepen nga punëdhënësi ose nuk merren nga punëmarrësi parashkruhet brenda 3 (tre) vjetëve nga dita në të cilën punëmarrësit i lind kjo e drejtë.

#### Neni 4 Pushimet e tjera

1. Punonjësit i jepet leje e pagueshme për rastet, si më poshtë vijon:

- a) martesën e tij 7 (shtatë) ditë;
- b) martesën e fëmijës 5 (pesë) ditë;
- c) lindjen e fëmijës (baballarët) 3 (tre) ditë;
- ç) vdekjen e prindërve, të gjyshërve, të bashkëshortes/it, të fëmijës, vëllezërve, motrave 7 (shtatë) ditë;
- d) ndërrim të banesës 3 (tre) ditë;
- dh) sëmundje të rënda të fëmijëve, prindërve apo bashkëshortit, të vërtetuara me raport të paافتësisë së përkohshme në punë 7 (shtatë) ditë;
- e) përgatitjen dhe mbrojtjen e titujve akademikë apo të gradës shkencore për punën që kryejnë 10 (dhjetë) ditë.

2. Për përfitimin e lejes së paguar, sipas pikës 1 të këtij neni, punonjësi paraqet në njësinë e burimeve njerëzore dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Njoftimin me shkrim;



b) Sipas rastit, dokumentin që provon shkakun ose rrethanën për të cilën i lind e drejta për të përfituar leje të paguar sipas këtij vendimi, si:

i. në rastet e përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b”, të pikës 1, të këtij neni, shpalljen e lidhjes së martesës apo çdo dokument tjetër që vërteton martesën, si dhe certifikatën e gjendjes familjare në rastin e martesës së fëmijës;

ii. në rastin e përcaktuar në shkronjën “c”, të pikës 1, të këtij neni, certifikatën e lindjes së fëmijës dhe certifikatën e gjendjes familjare;

iii. në rastet e përcaktuara në shkronjat “ç” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, raportin e paaftësisë së përkohshme në punë ose certifikatën e vdekjes;

v. në rastin e përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij neni, dokumentin që provon shitjen ose transferimin e pronësisë/posedimit mbi banesën e mëparshme dhe fitimin e titullit të pronësisë ose të posedimit mbi një banesë të re, si dhe vërtetimin nga njësia e vetëqeverisjes vendore për banimin në banesën e re;

vi. në rastin e përcaktuar në shkronjën “e”, të pikës 1, të këtij neni, vërtetimin nga institucioni i arsimit të lartë se është kandidat për fitimin e titullit në rastin e titujve akademikë ose vërtetim për regjistrimin e punonjësit në programin e studimeve të doktoraturës për gradën shkencore;

vii. çdo dokument tjetër të ngjashëm që provon shkakun ose rrethanën për të cilën i lind e drejta për të përfituar leje të paguar sipas këtij vendimi.

3. Në rastet kur pushimet e paguara përfitohen për shkaqet e parashikuara në shkronjat “c”, “ç” dhe “dh”, të pikës 1, të këtij neni, punonjësi është i detyruar të njoftojë njësinë e burimeve njerëzore përpara fillimit të lejes së paguar e të paraqesë dokumentacionin e përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, jo më vonë se dita e parë e kthimit në punë.

#### Neni 5

##### Orët shtesë të punës

1. Orët shtesë të punës kompensohen me pushim të barabartë me orët shtesë plus 25 për qind të tyre, kur këto orë janë kryer në ditë të zakonshme pune, apo me orët shtesë plus 50 për qind të tyre, kur orët janë kryer në ditë pushimi, ditë feste apo nga ora 22:00 deri në orën 06:00.

2. Kompensimi me pushim i orëve shtesë të punës dhe shërbimit bëhet brenda 2 (dy) muajve nga dita kur janë kryer ato. Në rast të pamundësisë

së kompensimit të orëve shtesë të punës apo shërbimit me pushim, punonjësi kompensohet me shtesë page, në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij neni.

#### KREU III

##### LEJA PA TË DREJTË PAGE

#### Neni 6

##### Leja pa të drejtë page

1. Punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit gëzon të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj ose afatgjatë deri në 1 (një) vit.

2. E drejta e lejes pa të drejtë page gëzohet për një periudhë afatgjatë deri në 1 (një) vit, vetëm për studime dhe kualifikime, brenda ose jashtë shtetit. Kërkesa për përfitimin e saj dorëzohet të paktën 3 (tre) muaj para.

3. Drejtori, zëvendës drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe oficerët nga shërbimet e Policisë Gjyqësore nuk përfitojnë leje pa të drejtë page deri në 1 (një) vit.

#### Neni 7

##### Leja pa të drejtë page deri në 1 vit

1. Kërkesa për leje pa të drejtë page deri në 1 (një) vit përmban përshkrimin e arsyes, afatin e lejes dhe të dhëna për institucionin ku punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit do të kryejë studime dhe kualifikime. Kërkesës i bashkëlidhet dokumentacioni justifikues.

2. Miratimi i lejes pa të drejtë page për një periudhë afatgjatë deri në 1 (një) vit bëhet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit me pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

3. Kërkesa e hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit shqyrtohet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i cili, kur vlerëson se kërkesa duhet miratuar, brenda 7 (shtatë) ditëve ia përcjell drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme për dhënien e pëlqimit për miratimin e lejes apo refuzimin e saj. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, pas marrjes së mendimit të mbledhjes së prokurorëve të posaçëm, shprehet për kërkesën brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga paraqitja e propozimit.



4. Kërkesa për leje refuzohet nëse studimi ose kualifikimi nuk përputhet me detyrën e punonjësit ose nëse ajo bie ndesh me interesat kryesorë të detyrës dhe vë në rrezik përmbushjen e detyrës me eficientë dhe në kohë.

5. Pas përfundimit të lejes punonjësi kthehet në pozicionin e mëparshëm.

6. Periudha e lejes pa të drejtë page nuk llogaritet në vjetërsi pune dhe as për efekt të ecurisë në karrierë.

#### Neni 8

##### **Leja pa të drejtë page deri në 2 muaj**

1. Punonjësit gëzojnë të drejtën e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj.

2. Punonjësi ka të drejtë që të kërkojë leje pa të drejtë page, për arsye personale ose për arsye shëndetësore që lidhen me fëmijët, bashkëshorten /in, bashkëjetuesen/in apo prindërit.

3. Për përfitimin e lejes vlerësohet çdo faktor i rëndësishëm, veçanërisht shkakun për të cilin kërkohet leja, kohëzgjatja e saj, planifikimet e lejeve të zakonshme për të gjithë punonjësit, numri i vendeve vakante, si dhe nevoja për të garantuar funksionimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

4. Për përfitimin e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj, punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit paraqet në njësinë e burimeve njerëzore, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së parashikuar të fillimit të lejes pa të drejtë page, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) kërkesën me shkrim;

b) sipas rastit, dokumentin që provon shkakun ose rrethanën për të cilën i lind e drejta për të përfituar leje pa të drejtë page, sipas këtij vendimi.

5. Në raste të veçanta, kur leja pa të drejtë page kërkohet për shkaqe që nuk mund të parashikoheshin, punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit mund të kërkojë fillimin e lejes jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e paraqitjes së kërkesës.

6. Kërkesa për leje pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj shqyrtohet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit jo më vonë se 48 (dyzet e tetë) orë nga data e paraqitjes së saj. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, me vendim të arsyetuar, miraton ose refuzon kërkesën për marrjen e lejes pa të drejtë

page. Në çdo rast, për miratimin e lejes afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj, drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit merr pëlqimin e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

7. Në rastet kur drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit refuzon kërkesën për marrjen e lejes pa të drejtë page, punonjësi ka të drejtë të paraqesë padi në gjykatën kompetente për çështjet administrative, sipas parashikimit të legjislacionit në fuqi për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

8. Periudha e lejes pa të drejtë page për një periudhë afatshkurtër deri në 2 (dy) muaj nuk llogaritet në vjetërsi pune dhe as për efekt të ecurisë në karrierë. Pas përfundimit të saj punonjësi kthehet në pozicionin e mëparshëm.

#### KREU IV

##### **TRAJTIMI FINANCIAR GJATË QËNDRIMIT NË PUNË**

#### Neni 9

##### **Trajtimi financiar i punonjësve**

Punonjësi, për shkak të përgjegjësisë dhe të rrezikshmërisë së lartë në detyrë në raport me strukturat e tjera të administratës shtetërore, ka përparësi në trajtimin financiar, ku përfshihen:

a) paga mujore;

b) ndihma financiare në masën e një page mujore në rastet e fatkeqësive në familje;

c) shpërblimi deri në masën e 6 (gjashtë) pagave mujore për rezultate të larta në kryerjen e detyrës;

ç) ndihma e menjëhershme financiare në rast të dëmtimit të rëndë të pronës, për shkak të detyrës, sipas akteve të vlerësimit të dëmit.

#### Neni 10

##### **Paga dhe ndihma e menjëhershme financiare**

1. Paga e punonjësit llogaritet sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

2. Punonjësit i jepet ndihmë e menjëhershme financiare, në masën e 1-mujore (njëmuajore) pagë mujore neto, për rastet e vdekjes së bashkëshortit/es, prindit apo fëmijës.

3. Pagesa jepet me urdhër të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.



## Neni 11

**Shpërblimi për rezultate të larta në kryerjen e detyrës**

1. Punonjësit përfitojnë shpërblim deri në masën e 6-mujore (gjashtëmujore) pagave mujore neto për rezultate të larta në kryerjen e detyrës. Për përfitimin e shpërblimit, punonjësi duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë kryer veprime procedurale komplekse me iniciativën e vet, me qëllim sigurimin e burimit të provave dhe identifikimin e personit, ndaj të cilit zhvillohen hetimet, të cilat kanë sjellë deklarimin fajtor të autorit të veprës penale, me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) të ketë marrë dijeni për veprën penale me iniciativën e vet dhe t'i ketë referuar prokurorit me shkrim fillimin e hetimeve kryesisht, për vepra penale të rënda që janë në kompetencën lëndore të Prokurorisë së Posaçme, me kushtin e deklarimit fajtor të subjektit me vendim gjyqësor të formës së prerë;

c) me iniciativën e vet, të ketë parandaluar ardhjen e pasojave të rënda për jetën dhe shëndetin e shtetasve nga vepra penale që janë në kompetencën lëndore të prokurorisë së posaçme;

ç) të ketë kryer veprime procedurale komplekse që kanë sjellë përfundimin me sukses të hetimeve pasurore, të cilat kanë rezultuar me konfiskimin e pasurive me vlerë mbi 1 miliard lekë, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

2. Përcaktimi i masës së shpërblimit bëhet, si më poshtë vijon:

a) në rastin e shkronjës “a”, punonjësi përfiton shpërblim në masën e 1 (një) page mujore;

b) në rastin e shkronjës “b”, punonjësi përfiton shpërblim në masën e 2 (dy) pagave mujore;

c) në rastin e shkronjës “c”, punonjësi përfiton shpërblim në masën e 3 (tre) pagave mujore;

ç) në rastin e shkronjave “a” dhe “b”, punonjësi përfiton shpërblim në masën e 4 (katër) pagave mujore;

d) në rastin e shkronjave “b” dhe “c”, punonjësi përfiton shpërblim në masën e 5 (pesë) pagave mujore;

dh) Në rastin e shkronjës “ç”, punonjësi përfiton shpërblim në masën e 6 (gjashtë) pagave mujore.

3. Bazuar në rezultatet e larta në kryerjen e detyrës, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 1

dhe 2, të këtij neni, prokurori i posaçëm, i caktuar për çështjen, i propozon mbledhjes së prokurorëve të posaçëm shpërblimin e punonjësit. Propozimi shoqërohet, për çdo rast, me relacionin shpjegues për arsyet dhe masën e shpërblimit. Sipas rastit, propozimi shoqërohet me dokumentacionin e nevojshëm për vlerësimin e rezultateve të larta.

4. Masa e shpërblimit jepet me urdhër të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, pasi mbledhja e prokurorëve të posaçëm ka vendosur shpërblimin e punonjësit.

## Neni 12

**Ndihma e menjëhershme financiare në rast të dëmtimit të rëndë të pronës**

1. Punonjësi, në rast të dëmtimit të rëndë të pronës për shkak të detyrës, përfiton ndihmë të menjëhershme financiare, në masën 100 (njëqind) për qind të vlerës së pronës së dëmtuar, por jo më shumë se 1 000 000 (një milion) lekë.

2. Punonjësi e përfiton ndihmën e menjëhershme financiare kur dëmtimi i pronës së paluajtshme ose të luajtshme vlerësohet më shumë se 100 000 (njëqind mijë) lekë.

3. Ndihma e menjëhershme financiare përfitohet kur punonjësi ka titull pronësie ose bashkëpronësie të pronës së dëmtuar apo kur objekti i ndërtuar pa leje është në proces legalizimi.

4. Punonjësit i jepet ndihmë e menjëhershme financiare, sipas këtij vendimi, vetëm në rast se nuk ka përfituar dëmshpërblim nga një shoqëri sigurimi për dëmtimin e pronës.

5. Punonjësi e përfiton ndihmën e menjëhershme financiare, kur:

a) prona i është dëmtuar si pasojë e veprës penale, e kryer në dëm të punonjësit, për shkak të detyrës dhe rasti është referuar në organin e ndjekjes penale;

b) prona i është dëmtuar aksidentalisht gjatë përdorimit të saj nga punonjësi për përmbushjen e detyrave zyrtare.

6. Për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare, punonjësi parashtrohet faktin e dëmtimit dhe dorëzon dokumentacionin pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit.

7. Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit urdhëron ngritjen e komisionit për verifikimin e faktit dhe vlerësimin e dëmit të shkaktuar. Urdhri



për ngritjen e komisionit i njoftohet punonjësit që ka kërkuar ndihmë të menjëhershme financiare.

8. Komisioni për verifikimin e faktit dhe vlerësimin e dëmit ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

a) zëvendës drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, në rolin e kryetarit;

b) 1 (një) punonjës përgjegjës për financat, i caktuar nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit;

c) 1 (një) punonjës përgjegjës për administrimin e aseteve, i caktuar nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit;

ç) 2 (dy) anëtarë nga personeli administrativ i Prokurorisë së Posaçme, të caktuar nga drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

9. Komisioni verifikon faktin e dëmtimit të pronës, bën vlerësimin paraprak të dëmit të shkaktuar dhe përputhshmërinë me kriteret për përfitimin e ndihmës së menjëhershme financiare, sa më shpejt, por jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë pune nga paraqitja e kërkesës së punonjësit. Komisioni i vë në dispozicion drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit përfundimet e arritura.

10. Pagesa për ndihmë të menjëhershme financiare për dëmin e shkaktuar bëhet me urdhër të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

11. Urdhri për dhënien e ndihmës së menjëhershme financiare shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

a) kërkesa me shkrim e punonjësit që përfiton ndihmën;

b) kopja e shkresës për referimin e veprës penale në organin e ndjekjes penale ose procesverbali që evidenton dëmtimin e rëndë të pronës;

c) dokumentacioni që provon titullin e pronësisë apo bashkëpronësisë mbi pronën e dëmtuar;

ç) procesverbali i hartuar nga komisioni, si dhe çdo dokument i prodhuar apo i administruar nga komisioni për verifikimin e faktit dhe vlerësimin e dëmit.

12. Kur nga hetimi apo gjykimi i çështjes provohet se dëmi i shkaktuar nuk ka ardhur për shkak të detyrës, punonjësi, që ka përfituar ndihmë të menjëhershme financiare, është i detyruar të kthejë në masën 100 (njëqind) për qind shumën e përfituar.

## KREU V

### E DREJTA PËR SIGURIM SHËNDETËSOR TË VEÇANTË

Neni 13

#### E drejta për sigurim shëndetësor të veçantë

1. Punonjësit përfitojnë sigurim shëndetësor të veçantë për shërbime shëndetësore të cilat nuk janë pjesë e paketave të shërbimit shëndetësor, që ofrohen nga Fondi për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

2. Sigurimi i shëndetit bëhet sipas kontratës së lidhur me shoqërinë e sigurimit, të përzgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik. Ky sigurim mbulon shpenzimet për kontrollin parandalues, diagnostikues dhe kurues, të ofruara nga institucionet shëndetësore, brenda dhe jashtë vendit.

## KREU VI

### E DREJTA PËR PËRFITIM TË KREDISË PËR STREHIM ME INTERESA TË BUTË

Neni 14

#### Kredi për strehim

1. Punonjësit, të cilët kanë nevojë për strehim, kanë të drejtë që një herë gjatë ushtrimit të detyrës të përfitojnë kredi për strehim me interesa të butë në masën 3 (tre) për qind. Shteti mbulon diferencën e interesave të kredisë përmbi çdo interes mbi 3 (tre) për qind për të gjithë shumën e kredisë, sipas marrëveshjes së lidhur me bankat e nivelit të dytë.

2. Me “nevojë për strehim”, sipas këtij vendimi, do të kuptohen rastet kur punonjësi nuk disponon një banesë për strehim ose kur disponon banesë në pronësi me sipërfaqe më të vogël se ajo e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për normativat e projektimit të banesave.

3. Kredia për strehim përfitohet në shumën e vlerës mesatare të një apartamenti prej 50 m<sup>2</sup> në vendin ku punonjësi ushtron detyrën. Për çdo anëtar të familjes, i cili jeton në të njëjtën banesë me punonjësin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, masa referuese e sipërfaqes së banesës shtohet me 10 m<sup>2</sup> për person.

4. Kredia për strehim jepet në vlerën deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë me interes në masën



(tre) për qind dhe me afat kthimi deri në 25 (njëzet e pesë) vjet dhe për sipërfaqe shtesë banimi, në vlerën deri në 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, me interes në masën (tre) për qind dhe me afat kthimi deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.

5. Mbulimi i interesave të kredisë ndërpritet kur punonjësi shkarkohet apo largohet nga Byroja Kombëtare e Hetimit.

6. Punonjësi nuk ka të drejtë të japë me qira banesën e përfutur me kredi për strehim me një interes në masën 3 (tre) për qind gjatë kohëzgjatjes së përfutur të kredisë për strehim.

#### Neni 15

##### Kushtet e përfutur të kredisë

1. Punonjësit i lind e drejta të përfutojë kredi për banim, sipas rregullave të këtij vendimi, në rastet kur plotëson kushtet e mëposhtme:

a) ka emërim përfundimtar;

b) nuk ka përfutur më parë kredi për banesë e financuar nga shteti;

c) nuk është përfutur kredi për banesë të subvencionuar nga shteti nga një person tjetër brenda familjes së punonjësit, i cili ka të drejtën e përfutur të kësaj kredie;

ç) punonjësi ose bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi /ja, fëmija i tij nën moshën 18 vjeç nuk kanë në pronësi pasuri të paluajtshme pa kolateral, për qëllime banimi ose pasuri të paluajtshme, që përdoren për veprimtari tregtare, shërbimi e prodhimi;

d) punonjësi ose bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi /ja, fëmija i tij nën moshën 18 vjeç nuk kanë pasuri të mjaftueshme për të blerë një banesë në shumën e vlerës përkatëse të kredisë së financuar nga shteti;

dh) ka jo më pak se 5 (pesë) vjet vjetërsi në detyrë pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit.

2. Me “pasuri të mjaftueshme” kuptohet çdo pasuri e luajtshme ose e paluajtshme, përfshirë mjetet motorike për qarkullim në tokë, det apo ajër, likuiditete (mjetet monetare në gjendje *cash*, llogari rrjedhëse, depozita, me dhe pa afat, bono thesari, obligacione dhe çdo lloj titulli tjetër pronësie të barasvlerëshme me to) tituj pronësie, përfshirë edhe të drejta reale pasurore, me vlerë të barabartë ose më të madhe se vlera e shumës maksimale për kreditim.

#### Neni 16

##### Dokumentacioni

1. Punonjësi, i cili gëzon të drejtën që të përfutojë kredi hipotekare me një interes në masën 3 (tre) për qind, sipas këtij vendimi, paraqet kërkesën me shkrim, pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit, të shoqëruar me:

a) certifikatën personale dhe certifikatën e gjendjes familjare, në çastin e dorëzimit të kërkesës;

b) deklaratën për rrethanat që mbështesin nevojën për strehim, sipas këtij vendimi;

c) vërtetimin nga punëdhënësi mbi të ardhurat neto të çdo anëtari të familjes mbi moshën 18 vjeç;

ç) vërtetimin nga Agjencia Kombëtare e Kadastrës se, në emër të tij dhe të çdo anëtari të familjes, nuk disponojnë në pronësi banesë a ndonjë mjedis që mund të përdoret si e tillë;

d) kopjen e deklaratës së interesave private.

2. Për çdo deklaram, për të përfutur kredi për strehim me një interes në masën 3 (tre) për qind, punonjësi konfirmon vërtetësinë e tyre dhe pranon kushtin për konvertimin e drejtpërdrejtë të kredisë për strehim me një interes, në masën 3 (tre) për qind të rimbursuar nga shteti në kredi tregtare, kur vërtetohen pavërtetësi në deklaram dhe/ose rrethana të rreme. Kopje e kësaj deklarate i vihet në dispozicion edhe institucionit bankar.

#### Neni 17

##### Përzgjedhja e bankës dhe shqyrtimi i kërkesave

1. Kredia për strehim financohet nga bankat e nivelit të dytë, sipas një marrëdhënieje tregtare, ku shteti do të ketë detyrimin për të paguar diferencën e interesit të kredisë së paguar nga punonjësi në masën 3 (tre) për qind me interesin e përcaktuar në marrëveshjen me bankën e përzgjedhur.

2. Trajtimi me kredi bëhet sipas marrëveshjes kuadër të nënshkruar ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe bankave të nivelit të dytë. Këshilli i Ministrave përfaqësohet nga ministri përgjegjës për strehimin, i cili vepron në emër dhe për llogari të Këshillit të Ministrave.

3. Përzgjedhja e bankës bëhet nëpërmjet një oferte publike dhe transparente, e cila u vihet në dispozicion të gjitha bankave që kryejnë shërbime





në territorin e Republikës së Shqipërisë, së bashku me kriteret e përzgjedhjes së ofertës fituese.

4. Përzgjedhja e ofertës fituese bëhet nga një komision vlerësimi që ngrihet me urdhër të ministrit përgjegjës për strehimin, me përfaqësues të ministrit përgjegjës për drejtësinë, Prokurorisë së Posaçme, Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe të Bankës së Shqipërisë.

5. Trajtimi me kredi për strehim me një interes në masën 3 (tre) për qind, sipas këtij vendimi, mund të bëhet edhe nëpërmjet bankave që kanë lidhur marrëveshje për zbatimin e programit të strehimit, në zbatim të legjislacionit në fuqi për strehimin social. Në këtë rast, menaxhimi i procesit pas miratimit të listës së përfituesve bëhet nga Enti Kombëtar i Banës.

6. Kërkesa e punonjësit për përfitimin e kredisë paraqitet pranë njësive të burimeve njerëzore e cila kryen verifikimin e plotësimit të kushteve dhe dokumentacionit përkatës.

7. Njësia e burimeve njerëzore harton një raport të detajuar dhe të argumentuar mbi pranimin ose refuzimin e kërkesës, të cilin e përcjell për miratim pranë drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

8. Kur gjatë apo pas zbatimit të kredisë rezultojnë se në kërkesë janë bërë deklarime të rreme apo punonjësi është shkarkuar apo larguar nga detyra, kredia konvertohet drejtpërdrejt në kredi tregtare, kusht i përcaktuar edhe në kontratën e kredisë.

9. Në rastin e bërjes së deklarimeve të rreme punonjësi është i detyruar të kthejë interesin e paguar nga shteti për kredinë, sipas marrëveshjes, të përcaktuar në vendim.

10. Në rast konstatimi të deklarimit të rremë, ndaj punonjësit bëhet referimi në organet e ushtrimit të ndjekjes penale.

## KREU VII SIGURIMI I JETËS

### Neni 18 Sigurimi i jetës

1. Punonjësit për shkak të natyrës së veçantë të punës që kryejnë përfitojnë sigurim jete.

2. Sigurimi i jetës mbulon rreziqet e dëmtimeve trupore, ku përfshihen paaftësia për punë, si dhe humbja e jetës që ndodh gjatë detyrës ose për

shkak të saj, në përputhje me kriteret e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Sigurimi i jetës realizohet nëpërmjet lidhjes së kontratës së sigurimit me shoqëritë e sigurimeve, të përzgjedhura sipas rregullave për prokurimin publik.

### Neni 19 Kontrata e sigurimit të jetës

1. Kontrata e sigurimit të jetës mbulon ngjarjet aksidentale gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, si më poshtë vijon:

a) Vdekje si rezultat i aksidentit ose ngjarje kriminale për shkak të detyrës;

b) Paaftësi e përhershme në punë ose aftësi e kufizuar në punë, ose një lloj i caktuar dëmtimi si rezultat i një aksidenti ose ngjarjeje kriminale për shkak të detyrës;

c) Paaftësi e përkohshme si rezultat i një aksidenti ose ngjarjeje kriminale për shkak të detyrës.

2. Kushtet standarde të kontratës së sigurimit, përfshirë tabelën e koeficientëve të përfitimit ndaj dëmtimeve trupore, të miratuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, shërbejnë si kushte minimale, të detyrueshme për t'u zbatuar nga shoqëritë e sigurimeve.

3. Për të përfituar sigurimin e jetës, punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit duhet të jetë deklaruar i vdekur nga organet kompetente mjekësore, të jetë shpallur i vdekur me vendim gjykatë ose të vërtetojë paaftësinë e përkohshme apo të përhershme në punë nëpërmjet dokumenteve mjekësore nga organet kompetente.

## KREU VIII MBROJTJA E VEÇANTË

### Neni 20 Mbrojtja e veçantë

1. Punonjësit i sigurohet mbrojtje e veçantë personale, e familjes dhe e pronës, sipas parashikimeve të këtij vendimi kur, gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të tij, i rrezikohet jeta, shëndeti i tij e i familjes ose pronë. Mbrojtje e veçantë i sigurohet edhe punonjësit që nuk e ushtron më detyrën, në rast se e kërkon, në rast



cenimi për shkak të ushtrimit të mëparshëm të detyrës.

2. Me “mbrojtje të veçantë personale, të familjes dhe të pronës”, sipas këtij vendimi, do të kuptohen masat me karakter organizativ e profesional për sigurimin dhe ruajtjen e veçantë fizike, mbrojtjen e familjes e të pronës së punonjësit, si dhe masat e tjera, që lidhen me këtë mbrojtje.

3. Kushtet për të përfituar mbrojtje të veçantë janë, si më poshtë vijon:

a) ekzistenca e dyshimit të arsyeshëm, i bazuar në prova për rrethana serioze, që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën;

b) prania e lidhjes shkakësore ndërmjet rrethanave serioze dhe ushtrimit të detyrës ose ushtrimit të mëparshëm të detyrës.

4. Pavarësisht mungesës së lidhjes shkakësore, të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 3, të këtij kreu, punonjësit i sigurohet mbrojtje e veçantë edhe në rast të pranisë së rrethanave serioze që rrezikojnë jetën, familjen ose pronën gjatë kohës së ushtrimit të detyrës.

5. Mbrojtja e veçantë personale sigurohet, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë dhe rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për procedurën e sigurisë së gjyqtarëve të gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, të prokurorëve të Prokurorisë së Posaçme dhe drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

6. Mbrojtja e veçantë, që i sigurohet drejtorit, zëvendës drejtorit dhe hetuesit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, sipas këtij kreu, në të njëjtat kushte dhe sipas së njëjtës procedurë, zbatohet dhe për oficerët nga shërbimet e Policisë Gjyqësore të Byrosë Kombëtare të Hetimit.

## KREU IX

### TRAJTIMI I FAMILJARËVE TË PUNONJËSVE QË HUMBASIN JETËN PËR SHKAK TË DETYRËS

#### Neni 21

##### Trajtimi i familjarëve të punonjësve

1. Kur punonjësi i Byrosë Kombëtare të Hetimit humb jetën për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë:

a) ndihmë të menjëhershme financiare, deri në 10 (dhjetë) paga mujore, sipas pagës referuese të muajit të fundit;

b) pension familjar suplementar, në masën 100 (njëqind) për qind të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periudha e sigurimit;

c) rimbursim, në masën 100 (njëqind) për qind të bursës së studimit në institucionet e arsimit publik për fëmijët e punonjësit;

ç) banesë falas për bashkëshortin/en dhe fëmijët kur janë të pastrehë;

d) ndihmë financiare, në masën e 1 (një) page mujore, sipas pagës referuese, për çdo përvjetor vdekjeje;

dh) organizimin dhe pagimin e shpenzimeve të ceremonisë mortore nga Byroja Kombëtare e Hetimit;

e) punësim me prioritet, në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kriteret e tjera të nevojshme për vendin e punës.

2. Përfitimit sipas pikës 1 të këtij neni, në çdo rast i shtohet përfitimi sipas kontratës së sigurimit të jetës dhe shëndetit.

3. Trajtimi financiar që fëmijët e punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit përfitojnë, në bazë të rregullave dhe të procedurave të përcaktuara në këtë vendim, zbatohet pa krijuar mbivendosje me ndonjë përfitim të mundshëm financiar sipas ligjeve të tjera. Në këtë rast, ata kanë të drejtë të zgjedhin trajtimin financiar më të favorshëm, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në atë ligj.

#### Neni 22

##### Ndihma e menjëhershme financiare

1. Pjesëtarët e familjes së punonjësit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, përfitojnë ndihmë të menjëhershme financiare, deri në 10 (dhjetë) paga mujore, sipas pagës referuese të muajit të fundit. Për t'u trajtuar me ndihmë të menjëhershme financiare, familjarët e punonjësit duhet të paraqesin pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Procesverbalin e referimit nga strukturat përkatëse të rrethanave të ngjarjes, në të cilat ka humbur jetën punonjësi ose çdo akt tjetër që vërteton faktin e humbjes së jetës për shkak të detyrës;



b) certifikatën e gjendjes familjare;  
c) certifikatën e vdekjes së punonjësit;  
ç) fotokopjen e letërnjoftimit të personit që kërkon përfitimin.

2. Kriteret për përcaktimin e masës së përfitimit të ndihmës së menjëhershme financiare janë, si më poshtë vijon:

- a) numri i personave në kujdestari;
- b) numri i trashëgimtarëve të paaftë për punë;
- c) numri dhe pasuria e pjesëtarëve të familjes.

3. Masa e ndihmës së menjëhershme financiare miratohet me urdhër të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, pas marrjes së mendimit të mbledhjes së prokurorëve të posaçëm.

#### Neni 23

##### **Pensioni familjar suplementar**

1. Pensioni familjar suplementar jepet në vlerën 100 (njëqind) për qind të pagës, sa herë që paga, sipas së cilës është llogaritur ky përfitim, ndryshon.

2. Përfitues të pensionit familjar suplementar janë pjesëtarët e familjes, si më poshtë vijon:

- a) fëmijët deri në moshën 18 vjeç;
- b) fëmijët deri në moshën 25 vjeç, kur vazhdojnë studimet e larta;
- c) bashkëshortja/i, kur nuk është i punësuar;
- ç) fëmijët mbi moshën 18 vjeç, që janë të paaftë për punë;
- d) prindërit e punonjësit që ka humbur jetën për shkak të detyrës.

3. Prindërit e punonjësit janë përfitues të pensionit familjar suplementar, për rastet kur nuk ka përfitues të tjerë sipas shkronjave “a”, “b”, “c” dhe “ç”, pavarësisht nëse kanë bashkëjetuar ose jo sipas certifikatës së gjendjes civile.

#### Neni 24

##### **Rimbursimi i tarifës së shkollimit**

1. Fëmijët e punonjësve, që kanë humbur jetën për shkak të detyrës, të cilët vazhdojnë studimet në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë rimbursim, në masën 100 (njëqind) për qind të tarifës së shkollimit.

2. Fëmijët e punonjësve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, paraqesin te Byroja Kombëtare e Hetimit dokumentacionin që provon statusin e tyre si studentë.

3. Byroja Kombëtare e Hetimit, për çdo vit akademik, i paraqet ministrisë përgjegjëse për arsimin listën e studentëve që rezultojnë fëmijë të punonjësve të Byrosë Kombëtare të Hetimit, që kanë fituar të drejtën e ndjekjes së studimeve të larta për trajtimin e tyre me bursë.

#### Neni 25

##### **E drejta për banesë falas**

1. Enti Kombëtar i Banesave trajton me banesë falas bashkëshorten/in dhe fëmijët e punonjësit, që ka humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, kur janë të pastrehë, sipas listës së miratuar nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) certifikatën e gjendjes familjare aktuale dhe certifikatën e gjendjes familjare në çastin e humbjes së jetës të punonjësit;

b) vërtetimin nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës për pjesëtarët e familjes përfituese, nëse kanë banesë në pronësi apo në bashkëpronësi ose nëse kanë aplikuar apo janë në proces legalizimi të ndërtimit pa leje me funksion banimi.

2. Familjarëve të punonjësit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, deri në përfitimin e banesës iu kompensohet qiraja e banesës. Në çdo rast, kompensimi i qirasë së banesës bëhet përkundrejt paraqitjes së kontratës së qirasë, në vlerë jo më të madhe se vlera minimale e qirasë, e përcaktuar në legjislacionin në fuqi për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore.

#### Neni 26

##### **Organizimi dhe shpenzimet e ceremonisë mortore**

1. Për t'u trajtuar me ndihmë financiare, për çdo përvjetor vdekjeje, pjesëtarët e familjes së punonjësit duhet të paraqesin pranë Byrosë Kombëtare të Hetimit dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën për përfitimin e ndihmës financiare;
- b) certifikatën e gjendjes familjare;



c) fotokopjen e letërnjoftimit të personit që kërkon përfitimin.

2. Dhënia e ndihmës financiare për çdo përvjetor vdekjeje miratohet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

3. Ceremonia mortore për punonjësit e Byrosë Kombëtare të Hetimit, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, organizohet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

4. Pagesa e shpenzimeve miratohet nga drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit, në bazë të dokumentacionit të mëposhtëm:

- a) kërkesës për miratim të shpenzimeve;
- b) faturës tatimore të shpenzimeve për organizimin e ceremonisë mortore.

Neni 27

### **E drejta e punësimit me prioritet**

Byroja Kombëtare e Hetimit, brenda limitit organik, trajton me prioritet aplikimin ose kërkesën për punësim të fëmijëve të punonjësve, që kanë humbur jetën në krye ose për shkak të detyrës, në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kriteret e tjera të nevojshme për vendin e punës.

## **KREU X**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

Neni 28

### **Dispozita të fundit**

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Byrosë Kombëtare të Hetimit.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

## **VENDIM**

**Nr. 440, datë 19.7.2023**

### **PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË KREDITIMIT STUDENTOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 114, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

## **VENDOSI:**

1. Studenti, me shtetësi dhe vendbanim në Shqipëri, i cili është regjistruar dhe ndjek studimet në një institucion të arsimit të lartë, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për kredi studentore, për financimin e kostove të studimeve.

2. Kostoja e studimeve, për efekt të masës së kredidhënies, përfshin tarifën e studimeve dhe kostot e jetesës. Kostot e jetesës përlllogariten deri në kufirin e pages minimale në shkallë vendi, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL), brenda muajit janar, negocion me bankat e nivelit të dytë për dhënien e kredive studentore, mbi bazën e kushteve, si më poshtë vijon:

- a) kredia studentore jepet pa kolateral fizik;
- b) kredia studentore jepet për mbulimin e kostove vetëm për ndjekjen e një programi studimi;
- c) financimi i kredisë bëhet me këste, të paktën dy herë në vit, dhe financimi i çdo kësti realizohet vetëm pas konfirmimit nga institucioni i arsimit të lartë, që studenti kredimarrës ka shlyer tarifën vjetore të shkollimit të vitit akademik dhe ka frekuentuar procesin mësimor;
- ç) detyrimi i shlyerjes së kredisë, përfshirë principalin dhe interesin e kredisë nga studenti kredimarrës, fillon jo më herët se 3 (tre) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të parë; jo më herët se 2 (dy) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të ciklit të dytë dhe jo më herët se 5 (pesë) vjet pas nënshkrimit të kontratës së kredisë, për rastet e kredisë së marrë për program studimi të integruar të ciklit të dytë;



d) norma e interesit të kredisë studentore të jetë më e ulët se norma mesatare e interesit për kreditë konsumatore, të dhëna nga institucioni kredidhënës për 2 (dy) vitet e fundit, përfshirë vitin në të cilin jepet kjo kredi;

dh) norma e interesit të kredisë të jetë e pandryshueshme gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës së kredisë.

4. Kushtet e tjera përcaktohen nga palët, kërkuesit për kredinë studentore dhe banka e nivelit të dytë, në kontratën e kredisë së lidhur ndërmjet tyre.

5. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë informon ministrinë përgjegjëse për arsimin për negociimet e zhvilluara me bankat e nivelit të dytë, duke i listuar ato sipas normës më të ulët të interesit të ofruar për kreditë studentore.

6. Studenti, i cili nuk është subjekt i përfitimeve prej akteve të tjera që mbështesin studentin me bursa, mbështetje financiare apo përjashtime nga tarifatat, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për kredi studentore pranë Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, brenda muajit shkurt. Bashkë me kërkesën, studenti paraqet dokumentacionin që vërteton regjistrimin si student në institucionin përkatës të arsimit të lartë dhe numrin e matrikullimit.

7. Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë, brenda muajit mars, vlerëson dhe rendit kërkesat e studentëve për kredi studentore, mbi bazën e kriterëve, si më poshtë vijon:

a) vlera e kredisë së kërkuar, sipas të cilës AKFAL-i i rendit kërkesat për kredi, duke preferuar kërkesat me vlerën e kredisë më të ulët;

b) lloji i programit të studimit ku është regjistruar studenti, i cili kërkon kredi. Nga kërkesat për kredi, të renditura sipas shkronjës “a”, preferohen kërkesat e paraqitura nga studentët e regjistruar në programe studimi, të përcaktuara si programe prioritare në institucione publike të arsimit të lartë, që plotësojnë detyrimin sipas pikës 6, të këtij vendimi, referuar akteve nënligjore në fuqi, si dhe në programe të tjera studimi, të ofruara nga institucione publike të arsimit të lartë;

c) rezultatet e studentit kërkues për kredi studentore. Kërkesat për kredi studentore, të cilat, sipas parashikimeve të dy pikave të mësipërme “a” dhe “b”, janë vlerësuar njëllor të preferuara, do të renditen sipas nivelit më të lartë të rezultateve të studentit që kërkon kredi. Rezultate të studentit,

sipas studimeve që ai ndjek, konsiderohen rezultatet, si më poshtë vijon:

i. Rezultatet e arsimit të mesëm të lartë, për studentët të cilët kërkojnë kredi studentore në vitin e parë të studimeve;

ii. Rezultatet e vitit/viteve akademik/e paraardhës/e, për studentët të cilët kërkojnë kredi studentore pas vitit të parë të studimeve për programet profesionale të ciklit të parë dhe programet e integruara të ciklit të dytë. Për studentët pas vitit të dytë përlllogaritja e notës mesatare bëhet si total i viteve të mëparshme të studimit;

iii. Rezultatet e ciklit të parë të studimeve për studentët që kërkojnë kredi kur janë regjistruar në një program studimi të ciklit të dytë, pavarësisht vitit që ndjekin.

8. Brenda afatit të përcaktuar në pikën e mësipërme, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë shpall renditjen e kërkesave për kredi studentore dhe informon ministrinë përgjegjëse për arsimin për këtë renditje.

9. Brenda 15 ditëve nga shpallja e listës me renditjen e kërkesave për të përfituar kredi studentore, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë ia paraqet këtë listë bankave të nivelit të dytë, të cilat kanë pranuar të ofrojnë kredinë studentore, sipas kushteve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, me normën më të ulët të interesit. Brenda të njëjtit afat, njoftohen edhe studentët për vijimin e procedurave dhe lidhjen e kontratës së kredisë me bankën përkatëse.

10. Numri i kërkesave për të përfituar kredi studentore, të cilat do të paraqiten te banka/bankat e nivelit të dytë, sipas përcaktimeve të pikës së mësipërme të këtij vendimi, do të rakordohet me fondin, i cili angazhohet çdo vit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për financimin e normës së interesit të kredive studentore.

11. Brenda muajit maj, me miratim të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë lidh me bankën e nivelit të dytë marrëveshje për të financuar një pjesë të normës së interesit të kredive studentore, që banka do të kontrakttojë me studentët, por jo më shumë se 5 (pesë) pikë përqindje të normës së interesit.

12. Pasi vlerëson respektimin e kushteve të skemës së kredisë studentore nga banka, për çdo kontratë kredie studentore, Agjencia Kombëtare e



Financimit të Arsimit të Lartë miraton financimin e pjesës së interesit të çdo kësti kredie të disbursuar kundrejt studentit, bazuar në nivelin e përcaktuar në marrëveshjen përkatëse të financimit.

13. Mundësimi i skemës së kredive studentore bëhet nëpërmjet fondit të financimit të interesit të kredive studentore për institucionet publike të arsimit të lartë. Ky fond është pjesë e programit buxhetor të arsimit të lartë, që përllogaritet deri në 0,5% të shumës vjetore të grantit të mësimdhënies, duke iu zbritur këtij granti dhe i transferohet bankës/bankave të nivelit të dytë nga ministria përgjegjëse për arsimin, në përputhje me marrëveshjen e nënshkruar ndërmjet tyre dhe AKFAL-it, në varësi të kontratave të kredive të nënshkruara.

14. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për ministrinë përgjegjëse për arsimin.

15. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

**VENDIM**  
**Nr. 441, datë 19.7.2023**

**PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË  
MJEKIMIT TË ZNJ. MIRA KAPISYZI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe të vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2023”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Mira Kapiszyzi, në masën 3 000 000 (tre milionë) lekë.

2. Ky fond përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

3. Pagesa bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

**UDHËZIM I PËRBASHKËT**  
**Nr. 100, datë 20.7.2023**

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR  
PAJISJEN E SHTETASVE SHQIPTARË  
DHE TË HUAJ ME DOKUMENTE  
BIOMETRIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 5, të ligjit nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar; të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar; të pikës 8, të vendimit nr. 80, datë 14.2.2023, të Këshillit të Ministrave”, “Për krijimin e shoqërisë aksionare për prodhimin dhe shpërndarjen e dokumenteve biometrike”, ministri i Brendshëm dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë

**UDHËZOJNË:**

1. Tarifat për pajisjen me dokumente biometrike janë sipas tabelës, si më poshtë:



| Kategoria                    | Emërtimi                          | Vlera e kuponit | Monedha | Vlera në lekë |       |        |
|------------------------------|-----------------------------------|-----------------|---------|---------------|-------|--------|
|                              |                                   |                 |         | Vlera pa TVSH | TVSH  | Total  |
| Letërnjoftim                 | Kupton standard                   | 1,500           | LEK     | 1,500         | 0     | 1,500  |
|                              | Kupon për ambasadë (ITA,GRC)      | 12              | EUR     | 1,354         | 0     | 1,354  |
|                              | Kupon Ambasada në SHBA            | 18              | USD     | 1,879         | 0     | 1,879  |
|                              | Kupon ambasada në vendet EU       | 16              | EUR     | 1,805         | 0     | 1,805  |
|                              | Kupton Ambasada në Mb. e Bashkuar | 13              | GBP     | 1,673         | 0     | 1,673  |
|                              | Kupton Ambasada në Zvicër         | 18              | CHF     | 2,060         | 0     | 2,060  |
|                              | Kupton Ambasada në Danimarkë      | -               | DKK     | -             | -     | -      |
| Pasaporta                    | Kupton standard                   | 7,500           | LEK     | 6,250         | 1,250 | 7,500  |
|                              | Kupon për aplikim të shpejtë      | 18,000          | LEK     | 15,000        | 3,000 | 18,000 |
|                              | Kupon për ambasadë (ITA,GRC)      | 130             | EUR     | 12,222        | 2,444 | 14,666 |
|                              | Kupon Ambasada në SHBA            | 240             | USD     | 20,883        | 4,177 | 25,059 |
|                              | Kupon ambasada në vendet EU       | 170             | EUR     | 15,982        | 3,196 | 19,178 |
|                              | Kupton Ambasada në Mb. e Bashkuar | 130             | GBP     | 13,942        | 2,788 | 16,730 |
|                              | Kupton Ambasada në Zvicër         | 204             | CHF     | 23,352        | 0     | 23,352 |
|                              | Kupton Ambasada në Danimarkë      | -               | DKK     | -             | -     | -      |
| Leje qëndrimi                | Kupon për leje qëndrimi           | 5,700           | LEK     | 4750          | 950   | 5,700  |
| Letenj. refugj.dok. udhëtimi | Kupon standard ID                 | 1,500           | LEK     | 1,500         | 0     | 1,500  |
|                              | Kupon standard për pasaporta      | 7,500           | LEK     | 7,500         | 0     | 7,500  |

2. Ngarkohet shoqëria “IdentiTek” sh.a. për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM  
**Taulant Balla**

MINISTËR I FINANCAVE  
DHE EKONOMISË  
**Delina Ibrahimaj**

**URDHËR**  
**Nr. 421, datë 14.7.2023**

**PËR IMPORTIN E KAFSHËVE TË  
LLOJIT DERRA, PRODUKTEVE,  
NËNPRODUKTEVE TË TYRE,  
MATERIALIT BIOLOGJIK,  
EMBRIONEVE, MISHIT DHE  
NËNPRODUKTEVE TË TYRE  
NGA SERBIA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 42 dhe 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

1. Lejimin e importit dhe tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 1.1 deri në pikën 1.8, përkatësisht nga shteti i Serbisë:

| Ndarja Administrative e nivelit të parë | Ndarja Administrative e nivelit të dytë | Ndarja Administrative e nivelit të tretë |
|-----------------------------------------|-----------------------------------------|------------------------------------------|
| Borski                                  |                                         |                                          |
| Braničevski                             |                                         |                                          |
| Jablanički                              |                                         |                                          |
| Južnobanatski                           |                                         |                                          |
| Nišavski                                |                                         |                                          |
| Pčinjski                                |                                         |                                          |
| Pirotski                                |                                         |                                          |
| Podunavski                              |                                         |                                          |
| Pomoravski                              |                                         |                                          |
| Zaječarski                              |                                         |                                          |
| Grad Beograd                            |                                         |                                          |
| Srednje-Banatski                        |                                         |                                          |



1.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtajes afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik, të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

1.2 Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së, sipas rastit.

1.3 Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tre vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtajes afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitullit 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

1.4 Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra që kanë origjinën nga tufat në të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit.

Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron, dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

1.5 Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) janë vrarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3, të Kodit Terrestrial të OIE-së, në një objekt ekzaminimi të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti.

1.6 Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:





a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15. dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16, të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.7 Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

1.8 Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinare duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajës afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose pikën 2, të nenit 15.1.4, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajës afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga Autoriteti Veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajës afrikane të

derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25, të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit, për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajës afrikane të derrave.

2. Urdhri nr. 374, datë 22.6.2023, “Për importin e kafshëve të llojit derra, produkteve, nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre nga Serbia”, shfuqizohet.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve, Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Frida Krifca**

**URDHËR**  
**Nr. 422, datë 14.7.2023**

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT NR. 27,  
DATË 26.1.2023, “PËR DISA MASA  
MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË  
INFLUENCËS AVIARE ME  
PATOGENITET TË LARTË TË  
SHPENDËVE TË SHFAQUR NË  
SHTETIN E HUNGARISË”**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, e Kushtetutës; neneve 42 dhe 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe ligjit nr. 44/2015,



“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

### URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 27, datë 26.1.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Hungarisë”.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE  
ZHVILLIMIT RURAL  
**Frida Krifca**

### VENDIM

**Nr. 39, datë 14.7.2023**

### NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

|                      |           |
|----------------------|-----------|
| Holta Zaçaj,         | kryetare; |
| Marsida Xhaferllari, | anëtare;  |
| Fiona Papajorgji,    | anëtare;  |
| Elsa Toska,          | anëtare;  |
| Sonila Bejtja,       | anëtare;  |
| Ilir Toska,          | anëtar;   |
| Genti Ibrahim        | anëtar;   |
| Marjana Semini,      | anëtare;  |
| Sandër Beci,         | anëtar,   |

me sekretare Belma Lleshi, në datën 14.7.2023, mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 37 (A) 2023 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Aleks Lici, Lefteria Lici

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Telemah Rajdho, Këshilli i Qarkut Gjirokastrë

OBJEKTI: Saktësim në vendimin nr. 28, datë 18.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Neni 80, i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”,

të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); neni 312 i Kodit të Procedurës Civile (KPC); neni 43 i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

### GJYKATA KUSHTETUESE,

e iniciuar kryesisht, pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi dhe diskutoi çështjen në tërësi,

### VËREN:

#### I

#### Rrethanat e çështjes

1. Kërkesit Aleks dhe Lefteria Lici, me kërkesën e datës 7.7.2022, i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

2. Gjykata, me vendimin nr. 28, datë 18.5.2023, ka vendosur: “1. *Pranimin e kërkesës.* 2. *Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-2166 (79), datë 7.3.2022, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.* 3. *Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.*”.

3. Pas shpalljes së vendimit në datën 19.6.2023, Gjykata ka konstatuar një gabim në shkrim në dispozitivin e vendimit të saj, konkretisht në pikën 3 të tij, ku është vendosur: “3. *Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.*”. Gabimi në shkrim lidhet me Kolegjin e Gjykatës së Lartë që është kompetent për rishqyrtimin e kësaj çështjeje, duke qenë i tillë Kolegji Civil dhe jo ai Penal referuar natyrës së çështjes gjyqësore në rastin konkret.

4. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se është në situatën kur kryesisht duhet të bëjë ndreqjen e gabimit në shkrim, sikurse një gjë e tillë lejohet nga neni 80, i ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit Gjykata ka të drejtë të ndreqë gabimet në shkrim, pa ndryshuar thelbin e vendimmarrjes, brenda 2 muajve nga shpallja e vendimit. I njëjti rregull parashikohet edhe në nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit kur kërkesa ka të bëjë me një vendim përfundimtar, kompetente për shqyrtimin e saj



është Gjykata. Gjithashtu, edhe neni 312 i KPC-së ka parashikuar se gjykata, me kërkesën e palëve ose kryesisht, mund të ndreqë në çdo kohë vetëm gabimet e bëra me shkrim ose në llogari, ose ndonjë pasaktësi të dukshme të vendimit.

5. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se dispozitivi i vendimit të saj nr. 28, datë 18.5.2023, duhet të saktësohet në këtë mënyrë: “3. *Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.*”.

#### PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, bazuar në nenin 80, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 312 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, njëzëri,

#### VENDOSI:

1. Saktësimin e pikës 3, të dispozitivit të vendimit nr. 28, datë 18.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese, i cili bëhet si vijon: “3. *Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Civil të Gjykatës së Lartë.*”.

2. Një kopje e këtij vendimi i bashkohet vendimit nr. 28, datë 18.5.2023, të Gjykatës Kushtetuese.

3. Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**Marrë më 14.7.2023.**

**Shpallur më 14.7.2023.**

**Kryetare:** Holta Zaçaj

**Anëtarë:** Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Genti Ibrahim

### BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AUTORITETIN KOMBËTAR PËR SIGURINË E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR (AKSIK)

Bazuar në ligjin nr. 10/2023, datë 2.2.2023, “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar, VKM nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, dhe në udhëzimin e drejtorit të DSIK-së nr. 99, datë 13.4.2017 “Për zbatimin e VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017 ‘Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror” (KDZH) në AKSIK, ka deklasifikuar Raportet e Grupit të Punës (GP), informacione të klasifikuara “Sekret shtetëror”, të nivelit “Sekret”, si më poshtë:

#### a. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:

1. Raport i GP-së nr. 11994, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Nafije Xhemal Hasko (Curri)**”.

2. Raporti i GP-së nr. 11670, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Alfred Avni Balla**”.

3. Raporti i GP-së nr. 11715, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Afërdita Kasem Maho (Lika)**”.

4. Raporti i GP-së nr. 11566, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Afrim Dali Shehu**”.

5. Raportet e GP-së nr. 12299, datë 2.11.2017 me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Artur Hysen Ismajlukaj**”.

6. Raporti i GP-së nr. 353, datë 1.2.2023, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Bledar Halil Mustafaraj**”.

7. Raporti i GP-së nr. 548, datë 15.2.2023 si dhe raporti nr. 12294, datë 2.11.2017 me lëndë:



“Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Ollga Ligor Visi**”.

8. Raporti i GP-së nr. 12401, datë 11.2.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Rovena Viktor Zoto**”.

9. Raporti i GP-së nr. 11732, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Ersida Enver Bajgora**”.

10. Raporti i GP-së nr. 11676, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Ndriçim Mustafa Troplini**”.

11. Raporti i GP-së nr. 11575, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Esmerilda Agim Habili**”.

12. Raporti i GP-së nr. 11877, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Ermal Zamir Tauzi**”.

13. Raporti i GP-së nr. 11406, datë 26.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Sokol Adrian Shehu**”.

14. Raporti i GP-së nr. 12486, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Dritan Galip Gripsi**”.

15. Raporti i GP-së nr. 12218, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Adriatik Bego Boca**”.

16. Raporti i GP-së nr. 12394, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Murat Rexhep Lleshi**”.

17. Raporti i GP-së nr. 11783, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Anila Kosta Karanxha**”.

18. Raporti i GP-së nr. 12331, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Rifat Zenel Kojku**”.

19. Raporti i GP-së nr. 12050, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Alma Miti Felaj**”.

20. Raporti i GP-së nr. 12444, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Elena Zoi Pelushi (Bakallbashi)**”.

21. Raporti i GP-së nr. 12007, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Laureta Ali Nezaj**”.

22. Raporti i GP-së nr. 11675, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Flora Selim Çela**”.

23. Raporti i GP-së nr. 12101, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Irena Stavri Çunoti**”.

24. Raporti i GP-së nr. 11882, datë 31.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Ejona Guri Lazellari**”.

25. Raporti i GP-së nr. 11704, datë 30.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Engjëllushe Isa Tahiri**”.

26. Raporti i GP-së nr. 12320, datë 2.11.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Tonin Ujk Sterkaj**”.

27. Raporti i GP-së nr. 11605, datë 27.10.2017, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit znj. **Alma Ramiz Kodraliu**”.

**b. Deklasifikoi pjesërisht informacionet e mëposhtme të nivelit “Sekret”:**

1. Raporti i GP-së nr. 264, datë 23.1.2023, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Skënder Riza Mestani**”.

2. Raporti i GP-së nr. 265, datë 23.1.2023, me lëndë: “Dërgohet raporti për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit z. **Neritan Ramis Hoxha**”.

